

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7624 E shtunë 18 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga VESKO GARÇEVIÇ

Ndarja Kosovë-Serbi mund të shkaktojë konflikte



Opinion

Ditës

Nga "DEUTSCHE WELLE"

E ardhmja e dollarit

Jam i sigurt, u shpreh ministri i Jashtëm rus Sergej Lavrov këto ditë në Ankara, se abuzimi i rëndë me dollarin si monedhë orientuese më në fund do ...

Vijon në faqen 2



Debat për projektligjin e PD-së për heqjen e simboleve komuniste

Vulosja e librave që u shkruan në diktaturë, Ymeri: Na kthen në diktat

Botuesi: Dekomunistizimi në këtë formë, imiton të shkuarën

FATMIRA NIKOLLI

Shënimi, siglimi, apo vulosja e veprave të artit të krijuara në diktaturë si për të thënë se ato përçojnë propagandën e kohës, nuk bën asgjë më shumë se të na kthejë në kohën e diktatit, daciaoave dhe dhunës. ...

Në faqen 12

ZBARDHET DOSJA, BISEDË E JURGIS ÇYRBES ME GILMANO DANIN, ÇFARE FOLEN

"SHULLAZI", PROKURORIA: DEPUTETI I PS INFORMATOR

Flet deputeti: I kam sqaruar organet kompetente të hetimit. Jam dhe para zgjedhësve, PD: Të arrestohet, është anëtar i bandës së Shullazit



(Në foto) Emiliano Shullazi. Deputet i PS Jurgis Çyrbja



Në faqen 3

ÇFARE THONE MEDIAT

Zëvendësimi i Lu-së, shtyhet dëgjesa në Senat për Kavalec, do rishikohet dosja

Në faqen 5

VENDIMI I MBROJTJES

Mali i Zi vendos ushtrinë në kufi me Shqipërinë: Ndalim emigrantëve drejt BE-së

Në faqen 4

PUNIMET NE SELITE

Thirrja e Veliajt: Bëni regjistrimin e adresave ku jetoni për të fituar investime

Në faqen 9

PROCEDURA

ALUIZNI, 470 personat që do të marrin tapitë në qarkun e Beratit, lista e plotë me emra

Në faqen 6

UDHEZIMI I RI



Transferim studimesh, në sa degë keni të drejtë të konkurroni dhe datat e aplikimit

Në faqen 8



Rozana Radi me pushime, foto me të dashurin. Një tjetër dasmë këtë fund vere, ja çifti...

Jonida Shehu rikthehet në ekran, ikën Anjeza Maja

Xhensila Pere: Konkurrin në krahë të një femre. Ja sa shpenzon Dua Lipa

Nga PAMELA ALIAJ

Ndërkohë që jemi ende në sezonin e nxehtë të verës, jemi edhe në një valë të madhe ndryshimesh të cilat presim t'i shohim të gjitha në shtator, atëherë kur fillon për të gjithë puna! Ndërsa lart e poshtë është



përfolur për largime dhe rikthime të reja, në kësaj radhe do të përqendrohemi në ndryshimet që do të pësojë televizioni i Top Chanel. Sipas burimeve të "BlueTooth" të "Gazeta Shqiptare" një figurë e njohur do t'i rikthehet ...

Suplement


DOSJA "SHULLAZI" PERGJIMET

Studim për veprat penale. Jail Crunch, qëllimi 'evidentimi i kategorive të krimeve'

Shqipëria me numrin më të lartë të të burgosurve në rajon


22.2% e të dënuarve në vend nën akuzë për vrasje

Numri i të burgosurve për 1000 banorë në Shqipëri llogaritet 1.9, më i larti ky krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, por më i ulët se i vendeve Baltike". Kjo sipas të dhënave të krahasueshme të Jail Crunch, pjesë e projektit OCCRP (Projekti i Raportimit të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar), i cili ka marrë në shqyrtim të dhënat mbi të burgosurit dhe veprat penale në disa prej vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore. Por, nëse krimi më i shpeshtë në vendet e rajonit është vjedhja, në Shqipëri peshën kryesore e të burgosurve e mbajnë ata që kanë kryer veprën penale të vrasjes, deklaracioni Monitor.al. Në Shqipëri, sipas grafikut, 22.2% e të burgosurve kanë kryer veprën penale të vrasjes në krahasim me rajonin. 98.27% e të burgosurve janë meshkuj ndërsa 1.73% janë femra. Në burgjet shqiptare pas vrasjeve, vendin më të lartë e zë vepra penale e vjedhjes dhe në vend të tretë trafiku i drogës. Ndërkohë numri i të burgosurve për 1000 banorë në Serbi llogaritet 1.4, në Bosnje dhe Hercegovinë 0.8, ndërsa në Kosovë për çdo 1 mijë banorë ka 1 të burgosur. Sipas kategorive të veprave penale, vrasjet zënë peshën më të lartë të krimeve të kryera nga të burgosurit, ndërsa në vendet e tjera të rajonit krimi më i shpeshtë është vjedhja. Në vend të dytë peshën më të lartë e zë vepra penale e vjedhjes dhe në vend të tretë trafiku i drogës. Në Serbi, e cila renditet e dyta ndër vendet e Ballkanit Perëndimor që projekti ka marrë në shqyrtim, krimi më peshën më të lartë është vjedhja dhe në vend të dytë është trafikimi i drogës. Në vendin fqinj Kosovë, vrasjet dhe vjedhjet kanë të njëjtë peshë krahasuar me totalin e veprave penale. Në Bosnje dhe Hercegovinë peshën më të lartë të veprave penale e ka vepra penale e vjedhjes,



BURGJET

Reporterët e projektit janë përpjekur që të ndajnë veprat penale në gjashtë kategori të mëdha si: vrasjet, vjedhjet, trafik droge, përdhunimet, trafikim qeniesh njerëzore dhe krime ekonomike. numri i të burgosurve për 1000 banorë në Shqipëri llogaritet 1.9, më i larti ky krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, por më i ulët se i vendeve Baltike.



Emiljano Shullazi në sallën e gjyqit

VRASJET

Të dhëna të tjera të INSTAT dhe Eurostat tregojnë se Shqipëria ka një numër shumë më të lartë vrasjesh për banorë se BE-ja. Sipas të dhënave kombëtare nga INSTAT në vitin 2015 në Shqipëri ndodhën 54 vrasje, ose 1.8 vrasje për 100 mijë banorë. Treguesi në Shqipëri është 2.5 herë më i lartë se mesatarja e BE-së.

Pistat e hetimit për 21-vjeçarin suedez

U kap me 19 pistoleta në Muriqan, prokuroria gati dy letër porositë për në Kosovë e Suedi

Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të nisë dy letërporosi për dy vende të ndryshme në lidhje me suedezin e arrestuar në Muriqan me 19 pistoleta. Mësohet se letërporositë do të dërgohen në Kosovë dhe Suedi. Prokuroria pritet t'i dërgojë një letër porosi organit të akuzës në Kosovë, ku 21 vjeçari Rickard Sebastian Vall, ka qëndruar për katër ditë, vend ku edhe ka marrë ngarkesën e armëve. Në letër porosi do të kërkohej pamjet nga kamerat e sigurisë, në vendet ku shtetasi suedez ka qëndruar për të zbuluar mbi personat e përfshirë në këtë trafik, pasi ende mbetet mister porositësi i armëve si edhe personi që i dorëzoi ato. Ndërsa një tjetër letër porosi pritet të dërgohet në Suedi, për të mësuar më shumë mbi të kaluarën e personit të dyshuar, nëse ka pasur apo precedentë të mëparshëm kriminalë.



Muriqan - Policia Kufitare godet një rast të trafikut astohet 21-vjeçari suedez me 19 pistoleta.

Një ditë më parë, ndërsa gjykata e krimeve të rënda caktoi masën e sigurisë arrest me burg për 21 vjeçarin, prokurori Vladimir Mara u

shpreh se nga hetimet rezultoi se ai ka udhëtuar në rrugë ajrore nga Suedia në Prishtinë, duke kaluar transit në Turqi. Në kryeqytetin

e Kosovës, ai ka qëndruar katër ditë, ku edhe ka marrë ngarkesën e armëve. Drejt Suedisë - theksoi prokurori - i dyshuari ka vendosur të kthehet në rrugë tokësore, me autobusin e linjës Kosovë-Gjermani. Sipas organit të akuzës, në pikën e kalimit kufitar, në Muriqan gjatë një kontrolli rastësor u zbulua ngarkesa me armë që i përkiste shtetasit suedez. Përpara grupit të hetuesve, prokurorëve, i riu ka deklaruar se do të bënte transportin kundrejt një shume parash, por pa dhënë detaje të mëtejshme. Ai ka refuzuar të zbulojë bashkëpunëtorët, duke pretenduar se si personin që i dorëzoi armët ashtu dhe pritësin e tyre, nuk i njihje. Aktualisht, Sebastian Vall po qëndron në masën e sigurisë "arrest në burg", të caktuar nga Krimet e Rënda.

numri i të burgosurve është 1.9 për 1000 banorë, por vepra me peshën më të madhe është vjedhja. Qëllimi kryesor i projektit, të cilët kanë krijuar grafikë interaktivë, më të dhënat e marra nga autoritetet e burjeve përkatëse për secilin shtet ishte evidentimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve në vende të ndryshme demografike dhe kategorive të krimeve në rajon. Reporterët e projektit janë përpjekur që të ndajnë veprat penale në gjashtë kategori të mëdha si: Vrasjet, Vjedhjet, Trafik Droge, Përdhunimet, Trafikim Qeniesh Njerëzore dhe Krime Ekonomike. Të dhëna të tjera të INSTAT dhe Eurostat tregojnë se Shqipëria ka një numër shumë më të lartë vrasjesh për banorë se BE-ja. Sipas të dhënave kombëtare nga INSTAT në vitin 2015 në Shqipëri ndodhën 54 vrasje, ose 1.8 vrasje për 100 mijë banorë. Treguesi në Shqipëri është 2.5 herë më i lartë se mesatarja e BE-së. Vendet e BE-së përllogariten në vitin 2015 gjithsej 3600 jetë të humbura nga vrasjet, por prevalenca për 100 mijë banorë ka shënuar ulje të dukshme, duke arritur 0,7 vrasje për 100 mijë banorë nga 1.3 vrasje për 100 mijë banorë në vitin 2002, sipas të dhënave të Eurostat.

në vend të dytë të burgosurit që kanë kryer vrasje dhe në të tretin ata që janë dënuar

për trafik droge. Vendi me numrin më të lartë të të burgosurve ndër 12 vendet e

marra në shqyrtim është Lituania, me 3.2 të burgosur/1000 banorë. Më pas

renditet Ukraina me 2.8 të burgosur, Letonia me 2.5 dhe Moldavia me 2.2. Në Turqi



Zbardhen dy komunikimet telefonike të kryera nga një ish-zyrtar i lartë i Hipotekës në Durrës

"E kemi keq punën", dalin përgjimet mes deputetit të PS-së dhe Gilmando Danit

Dosja 'Shullazi', si e informoi Jurgis Çyrbja bandën për hetimet e prokurorisë

Ndërkohë që gjyqi ndaj Emiljano Shullazit dhe miqtë të tij është në fazën e konkluzioneve përfundimtare, të tjera përgjime dalin në dritë. Prokuroria e Krimeve të Rënda pas një hetimi të nisur në shkurt të vitit 2016, nën përgjim dhe vëzhgim Shullazit dhe katër të pandehurit e tjerë: Gilmando Dani, Blerim Shullazi, Endrit Qyqja, Endrit Zela. Mes dhjetëra telefonatave në rrjetën e përgjimit të prokurorëve, kishte rënë Jurgis Çyrbja, ish-zyrtar i lartë i Hipotekës në Durrës, aktualisht deputet i Partisë Socialiste. Referuar dosjes hetimore rezultojnë se menjëherë sapo një oficer i policisë gjyqësore shkoi në zyrat e Hipotekës në Durrës për të sekuestruar praktikën e regjistrimit të ish-hotel Vollgës, Çyrbja telefonon Gilmando Danin, i konsideruar si krahu i djathtë i Shullazit. Ligjvënësi e informon atë, se prokuroria ishte vënë në lëvizje dhe shprehte shqetësim për këtë fakt. "E kemi keq punën. Lidhet me detyrën time", dëgohet Çyrbja t'i thotë të pandehurit. Po atë ditë, prokurorët e ftuan Çyrbjan, të jepte shpjegime në cilësinë e personit që kishte dëgjim për rrethanat e hetimit. Pasi mbaron rrefimin e tij, pa kapërcyer rrethimin e godinës së xhamtë, ligjvënësi telefonon sërish Gilmando Danit dhe i kërkon të takohen. Nga ai moment deputeti dhe i dyshuari nuk rezultoi të kenë folur më në telefon. Pak muaj më vonë Çyrbja u ballafaqua në sallën e gjyqit me Shullazin dhe të pandehurit e tjerë duke dhënë dëshminë e tij. Ai foli asokohe edhe për një takim që kishte pasur me Emiljano Shullazit, për çështjen e ish-hotel Vollgës, por nuk pranoi të kishte pasur komunikime me miqtë e tij përmes telefonit, ku i informonte për gjithë sa ndodhte. Ndërkohë Shullazi dhe miqtë e tij, ndaj të cilëve rëndojnë akuzat të rënda, si gjobënie apo shkatërrim prone me eksploziv presin shtatorin për të dëgjuar presencën e prokurorisë.



Gilmando Dani



Emiljano Shullazi

PËRGJIMI

"E kemi keq punën. Lidhet me detyrën time", dëgohet Çyrbja t'i thotë të pandehurit. Po atë ditë, prokurorët e ftuan Çyrbjan, të jepte shpjegime në cilësinë e personit që kishte dëgjim për rrethanat e hetimit. Pasi mbaron rrefimin e tij, pa kapërcyer rrethimin e godinës së xhamtë, ligjvënësi telefonon sërish Gilmando Danit dhe i kërkon të takohen.

PD: Të arrestohet, deputeti Jurgis Çyrbja, është anëtar i bandës së Shullazit

Duke bërë deputet Jurgis Çyrbjen, Edi Rama e shpërbleu dhe mori në mbrojtje bandën e Emiljano Shullazit". Kështu është shprehur ditën e djeshme, përmes një deklarate për mediat, deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj. Ai theksoi se Jurgis Çyrbja deputet i PS dhe njëkohësisht ish-zyrtar i lartë i hipotekës në Durrës është anëtar i bandës së Shullazit dhe duhet të ishte në burg. Alibeaj tha se Jurgis Çyrbja u kap në përgjime duke informuar bandën e Shullazit për hetimet e prokurorisë për hotel Vollgën. Ai i bëri thirrje prokurorisë të sjellë në Kuvend kërkesën për arrestimin e deputetit. "Jurgis Çyrbja, deputet i Edi Ramës në Shijak, është simbol sesi kryeministri i vendit vazhdon bashkëqeverisjen me krimin e organizuar. Përgjimet e bëra publike sot nga media provojnë qartë se deputeti i Edi Ramës, Jurgis Çyrbja, është anëtar i bandës së Emiljano Shullazit, por ndryshe nga ai, nuk është në burg, por anëtar i parlamentit. Sipas përgjimeve të publikuara, deputeti Çyrbja ka komunikuar të paktën dy herë në telefon me Gilmano Danin, krahu e djathtë i Emiljano Shullazit për çështjen e hotel Vollgës, e cila është regjistruar në pronësi të Emiljano Shullazit nga Jurgis Çyrbja. Në të dyja rastet, ai e informon Gilmano Danin për veprimet e prokurorisë. Telefonata e parë u bë prej anëtarit të bandës në krye të Hipotekës menjëherë pas sekuestrimit të dosjes së hotel Vollgës nga prokuroria. "E kemi keq punën. Lidhet me detyrën time", janë fjalët e deputetit Çyrbja në adresë të Gilmano Danit, i cili ka qenë në përgjim. Telefonata e dytë mes të dyve është kryer menjëherë sapo ish kreu i hipotekës ka dalë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe i ka kërkuar takim. Gilmano Danit krahu të djathtë të Emiljano Shullazit", deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj.

Reagon deputeti i PS, Jurgis Çyrbja: Korrekt para ligjit dhe para zgjedhësve

Pas publikimit të përgjimeve telefonike të kryera mes një prej anëtarëve të bandës Shullazi, Gilmando Danit, dhe deputetit të PS Jurgis Çyrbja, ky i fundit ka reaguar përmes një postimi në rrjetin e tij social 'Facebook'. Çyrbja shpjegon se në lidhje me pretendimet e ngritura ka dhënë sqarimet e tij në prokurori rreth një viti më parë. "Jam i detyruar të jap një shpjegim publik si detyrim ndaj zgjedhësve të mi mbi atë çfarë në media është



transmetuar dhe më pas është keqpërdorur si gjithmonë nga opozita pa ekip dhe pa lidhshmëri. Gjithçka preten-

dohet sot i kam sqaruar në prokurori dhe në dëshminë time përpara organeve të drejtësisë më shumë se një vit më parë. Dua të informoj publikun se kjo është një çështje e hetuar nga prokuroria ku unë kam dhënë të gjithë informacionet dhe dëshmitë. Ata që sponsorizojnë lajme vere, nuk do të arrijnë qëllimin për të dëmtuar imazhin tim dhe të grupit parlamentar ku kam nderin të bej pjesë, sikundërse nuk e arrijnë edhe para një viti me po të njëjtin lajm vere.

Banda 'Shullazi' akuzohet për shtrëngim me anë të kanosjes për dhënie të pasurisë ndaj disa biznesmenëve në Tiranë dhe në Durrës, si dhe për kanosje në formën e grupit të strukturuar kriminal. Konkretisht për veprat penale "Shtetërgimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë", "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit", "Kanosje për shkak të detyrës", "Trafikimi i narkotikëve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal". Të pandehurit Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Besmir Shullazi, Endrit Qyqja, Endrit Zela

rrezikojnë dënime deri në 15 vite burg. **AKUZAT** Prokuroria i akuzon të pandehurit se duke vepruar si grup i strukturuar kriminal kanë shtrënguar me anë të kanosjes shtetasin Ylvi Beqja dhe ky i fundit i kaloi në pronësi Emiljano Shullazit një pjesë të ish-hotel "Vollga" në Durrës, si edhe shuma të konsiderueshme monetare. Sipas akuzës në janar 2016, të akuzuarit kanë shtrënguar për dhënie pasurie shtetasin Adriatik Kërçuku, i cili ishte pronar i një biznesi në Lushnjë. Dy muaj pas kërcënimeve ndaj këtij shtetasi, konkretisht në Mars 2016, pjesëtarët e grupit, akuzuarit se kanë

vendosur dhe shpërthyer lëndë plasëse tritol në ambientet e biznesit të të dëmtuarit Adriatik Kërçuku. Në shkurt 2016, grup akuzohet se kanë shtrënguar për dhënie pasurie shtetasin Jani Zaka, i cili posedonte pronë në Tiranë, ku akuzohen se i kanë vendosur lëndë shpërthyes tritol një garazhi në pronësi të tij, në shenjë kërcënimi për qëllime përfitim të paligjshëm. Në prill 2016, të pandehurit akuzohen se kanë shtrënguar për dhënie pasurie shtetasin Dhori Kule dhe Myrnyr Kone, pedagogë dhe drejtues në Universitetin e Tiranës, me qëllim që profesor Kone të largohej nga gara për Rektor në këtë Universitet.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 01 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do të shqyrtohen ofertat për ankandin e l-rë për shitjen e pasurisë së "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës.
Pasuria përbehet nga dy dyqane (gjithej rreth 245 m²) dhe tre apartamente (gjithej rreth 245 m²) dhe mbi këto prona nuk rëndojnë barrë hipotekore apo nuk janë të kulluara nga detyrime të tjera. Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 54.000 lek/m², ndërsa çmimi fillestar për dyqanin do të jetë 81000 lek/m².

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-222-6000
E-mail: best2010@pembraues.al, web: www.pembraues.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 15 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do të zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin i l-rë, për shitjen e pasurisë nr.4/562/ND/N7, me çmim fillestar 7.695.000 lek.
Prona me sipërfaqe 95 m² i takon z. Sami Zeqir Zeqija, ajo ndodhet pranë dyqanit të ALBITAL-CANON, Rruga Egnatiana,nr.4, Durrës.

P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë deponuar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë derdhor në BKT, nr.logarise Saimir Hoxha PF (IBAN:AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA).

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Dytë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 2503/1-2, Vol.-31, fq.234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5'284.440 Lekë.
- Pasuria Nr. 2503/1-3, Vol.-31, fq.235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 5'284.440 Lekë.
- Pasuria Nr.211/11, Vol.-4, fq.-201, Z.k-1791, Illoj Tokë-OARë me Sip.- 500 m², ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 280.000 Lekë.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 23.08.2018 në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069.723.003, email: medar.kajolli@yahoo.com

EMIGRANTET KUFIRI

Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi: Do ndalojmë kalimet e paligjshme

Klandestinët, Mali i Zi vendos ushtrinë në kufi me Shqipërinë

Shtohet numri i emigrantëve që synojnë kalimin në Europë

Kalimi i emigrantëve klandestinë prej Shqipërisë drejt vendeve të BE ka vënë në alarm Malin e Zi. Ministria e Mbrojtjes së këtij shteti ka bërë të ditur se prej të enjtes ushtria është vendosur në kufirin me Shqipërinë për të ndaluar kalimin e emigrantëve që vijnë prej zonave të luftës. "Kufiri do të kontrollohet nga patrulla policore të përziera të policisë dhe Armatës së Malit të Zi, kryesisht për të parandaluar kalimet e paligjshme të kufirit shtetëror me Republikën e Shqipërisë, si dhe veprime të tjera të paligjshme në kufi dhe në zonën kufitare", thuhet në deklaratën për mediat. Po ashtu saktësohet se nisma është marrë në bazë të vendimit të këshillit të mbrojtjes dhe të sigurisë. Ndërkohë dhe në Shqipëri është forcuar kontrolli kufitar. Vetëm në datën 8 gusht janë ndaluar 16 emigrantë që ishin nisur prej Sirisë dhe Irakut për të kaluar drejt vendeve të BE. Në të njëjtën zonë në datën 3 gusht janë ndaluar dhe 14 të tjerë. Pas shoqërimit në komisarjat ku japin dëshminë emigrantët dërgohen në qendrën e azilit. Por shpesh dhe prej aty gjenden rrugët për të vazhduar tentativën e kalimit në vendet e unionit. Për shkak të situatës së krijuar kreu i departamentit për mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Malit të Zi paralajmëroi në muajin maj ngritjen e një muri me tela. Por që tashmë duket se pengesë do të bëhet ushtria. Edhe Komisioni Europian ka marrë në diskutim situatën e krijuar. Për këtë qëllim u propozua dhe prezenca e 30 forcave të Fronteks në kufirin me Shqipërisë dhe Greqinë. Por dhe mes vendeve të BE debati ka mbetur i hapur ku propozimi për shpërndarjen e drejtë të azilkërkuësve dhe ideja e qëndrimit në vendin e parë mbeten molla e sherrit për shtetet më të mëdha të unionit. Ndërkaq, numri gjithnjë në rritje i emigrantëve sirianë e jo vetëm, raportohet dhe nga autoritetet shtetërore



SHIFRAT

Mali i Zi, Shqipëria dhe Bosnja kanë parë një rritje të numrit të refugjatëve dhe emigrantëve që shkojnë në veri në Kroacinë anëtare të BE-së që nga fillimi i vitit 2018 - një total prej 6,700 emigrantësh.

Dialogu Kosovë-Serbi, Delawie: Duam marrëveshje që zgjidh probleme

Vuçiç, në Kosovë më 9 shtator: Kufijtë na i kanë përcaktuar fuqitë perëndimore

Aleksandar Vuçiç konfirmoi vizitën e tij në Kosovë më 9 shtator. "Nëse çdo gjë do të shkojë sipas planit, në këtë datë do të jem me serbët në Kosovë", u shpreh presidenti serb në një intervistë për "RTS", ku theksoi se, edhe Amerika është kundër ndarjes së Kosovës, e se bashkë me Berlinin i kanë përvijuar kufijtë e saj në dem të Serbisë. "Kemi një territor të përcaktuar nga ana e fuqive perëndimore, që shkon kundër nesh", citohet të ketë thënë Vuçiç. "Kufijtë në Jarinjë dhe Bërnjak janë vendosur përfundimisht në vitin 2011, ne i quajmë kalime administrative, sepse nuk i njohim, por nuk mund të hyjmë në Kosovë e të mos e kalojmë këtë kufi", ka shtuar ai. Kreu i shtetit serb, sidomos theksoi se qëllimi kryesor i Beogradit është ruajtja e paqes në Kosovë. Më herët, Vuçiç pati komentuar pa tone të ndezura de-



klaratën e Kancelares gjermane, Angela Merkel, që kundërshtonte rishikimin e kufijve, duke theksuar se qëndrimi i Perëndimit pr shtetit të Kosovës dhe territorit të saj nuk është gjë e re. Ndërkaq, ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, ka deklaruar se marrëveshja Kosovë-Serbi duhet të vijë nga vetë partitë politike. Delawie përmes një mesazhi në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane ka thënë se SHBA-të janë të përkushtuar për suksesin ekonomik dhe sovranitetin e

Takimi

Kryeministri i Malit të Zi Dushko Marković ka zhvilluar një takim me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. Pas takimit faqja zyrtare e kryeministrit në Mal të Zi ka shkruar se nuk ka ndryshim të kufijve në Ballkan. "Nuk ka ndryshim të kufijve në Ballkan", thuhet në njoftimin e qeverisë së Malit të Zi në Twitter.

vendit, por që nuk duan një marrëveshje që krijon më shumë probleme sesa që zgjidh. "Duam të ndihmojmë në arritjen e një marrëveshjeje të zbatueshme, të qëndrueshme dhe që i kontribuon stabilitetit në rajon. Çdo marrëveshje duhet të garantojë sigurinë për të gjithë qytetarët e saj, duke përfshirë grupet e pambrojtura, serbët e Kosovës dhe kishën ortodokse serbe. Dhuna dhe kërcënimet për dhunë janë të papranueshme", tha ambasadori.

dit tonë, por siç ata vetë shprehën, destinacioni i tyre final nuk është Shqipëria. 2018 ka shënuar dhe shifrat më të larta të emigrantëve të paligjshëm që kanë ndjekur rrugën e



Thaçi: Dialogu me Serbinë, do sjellë njohjen reciproke

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi është shprehur sot se fundi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, duhet të sigurojë njohje reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Në një postim në Twitter Thaçi shkruan se mendimet e tjera rreth rezultateve të këtij dialogu, janë të pakuptimta apo interpretime false. "Fund i dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë, përfshirë edhe demarkacionin e 400 kilometrave në mes të dyja vendeve, duhet të përmbyllet me njohje reciproke dhe anëtarësim të Kosovës në OKB dhe organizata tjera. Mendimet e tjera rreth rezultateve të këtij dialogu, janë të pakuptimta apo interpretime false" - shkroi dje, Presidenti Thaçi në Twitter.



Sulmohet me bojë rajoni i policisë, arrestohet deputetja e Vetvendosjes

Para stacionit kryesor të Policisë së Kosovës, dhjetëra aktivistë të VV-së kanë hedhur bojë me ngjyrë të kuqe në shenjë proteste për "mos reagimin e policisë për dhunën ndaj grave". Pas aksionit policia ka arrestuar disa prej tyre, përfshi këtu edhe deputeten e Vetëvendosjes, Saranda Bogujevci, e cila u lirua më pas. Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se pas aksionit të djeshëm të aktivistëve të saj, janë arrestuar edhe 6 aktivistë të tjerë. "Vetëvendosja zhvilloi një aksion simbolik pranë Stacionit të Policisë në lidhje me neglizhencën e institucioneve të Republikës së Kosovës për dhunën ndaj grave", thuhet në njoftimin e Vetëvendosjes. Të arrestuarit e tjerë veç deputetes sipas VV-së janë: Rinë Zhitia, Diellëz Arifi, Elona Kurti, Çlirim Gërbeshi, Atdhe Arifi, Patrik Domi. E gjithë kjo protestë e mori pikënisjen nga krimi i dyfishtë që ndodhi në Gjakovë mbremjen e 7 gushtit teksa një kryefamiljar vrau gruan dhe vajzën e tij 9-vjeç.

Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Shqipërisë për të arritur në vendet e BE-së. Vetëm gjatë muajit korrik janë regjistruar 170 persona që kanë kaluar kufirin në mënyrë të

paligjshme, ndërsa 120 të tjerë vetëm në 15 ditët e para të muajit gusht. Shifra këto që tregojnë se numri është rritur ndjeshëm gjatë dy muajve të fundit.



DAVID MUNIZ

Zv.ambasadori i SHBA në Tiranë, David Muniz largohet nga Shqipëria me fjalë premtuese. Shihni mesazhin e tij të plotë për Shqipërinë dhe shqiptarët. "Kam besuar gjithnjë se Shqipëria ka një të ardhme të ndritur... Asgjë nuk e ka ndryshuar mendimin tim dhe sot besoj akoma edhe më shumë sesa kur mbërrita për herë të parë, që ky vend ka një të ardhme shumë të ndritur".



Pampuri: Shqipëria, "çmendina e madhe" e dyshes Rama- Veliaj

Pas situatës së rëndë të krimit në vend dhe shtimit të numrit të vetëvrasjeve reagoi dje edhe deputetja demokratike, Orjola Pampuri. Ajo denoncon rritjen e kriminalitetit në vend dhe talljen e qeveritarëve me jetën e shqiptarëve. Për këtë, ajo bën përgjegjës dhe akuzon kreun e qeverisë dhe kryebashkiakun e Tiranës. "Nëse kryeministri qethet 'live' që të zhvendosë vëmendjen nga çmendina që po përgatit çdo ditë për qytetarët, e kryebashkiaku llafazan zëvendosë flet në delir për atë që po bën për të përmirësuar situatën e vefotruar kaotike në vend, ndërkohë nga ana tjetër Tiranë po helmohet nga ajri i ndotur i djegies së plehrave të Sharrës, nga shpërthimet e bombolave në cerdhe e shumë bëma tjera, sigurisht që çdo ngjarje e cila lidhet me shëndetin mendor nuk përbën risi, pasi është e nxitur e mbështetur nga vetë kjo qeveri", shkruan deputetja e PD-së.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com

Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Enkeleza Novaku dhe dorëzuesit Adriatik Novaku:
"Tsuall" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndërtesë" me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lajla Nr. 1, Pogradec. Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 7 280 000 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

Mediat amerikane: Kavalec, e përfshirë në dosjen e debatueshme të Trump për zgjedhjet presidenciale

Kavalec mund të mos zëvendësojë Lu-në, shtyhet dëgjesa në senat

Rishikim për të nominuarin si ambasador në Shqipëri

Enominuara e Donald Trump si ambasadore e SHBA-ve në Tiranë, Kathleen Kavalec, pritej të zhvillonte dëgjësën në senat, por ajo nuk është paraqitur. Duke u interesuar për të mësuar arsyet e mungesës së saj, "Vizion Plus" pyeti zëdhënësin e senatorit amerikan, Bob Corker, kreu i komitetit për marrëdhëniet me jashtë, i cili dha këtë përgjigje: "Vumë re se një numër i anëtarëve të komisionit po kërkojnë informacione shtesë. Ne do të rishohim në një seancë për të nominuarin që do të shërbejë si ambasador në Shqipëri sa më shpejt të jetë e mundur". Rreth një muaj më parë, emri i Kathleen Kavalec u nominua nga presidenti Donald Trump si ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë pas përfundimit të mandatit të diplomatit, Donald Lu. Por ditët e fundit mediat amerikane shkruajnë se emri i Kavalec, dikur zëvendës ndihmëssekretare e në Byronë e Çështjeve Evropiane të Departamentit të Shtetit është përfshirë në dosjen e debatueshme të Trump për zgjedhjet presidenciale. Kathleen Kavalec është nominuar më datë 3 korrik nga presidenti amerikan, Trump, për këtë pozicion, ndërsa pret tashmë vetëm miratimin nga senati, një hap ky thuhet formal, për të mbërritur në vendin tonë. Ajo njihet si një diplomate karriere, me një përvojë rreth 30-vjeçare si përfaqësuese e Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare. Kathleen Ann Kavalec aktualisht shërben si zëvendës ndihmëssekretare në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Eurozotatike në Departamentin Amerikan të Shtetit. Zëvendës ndihmëssekretarja për Zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Eurozotatike në Departamentin e Shtetit, Kathleen Kavalec e ka marrë detyrën si zëvendës ndihmëssekretare në gusht 2015.



E nominuara e Donald Trump si ambasadore e SHBA-ve në Tiranë, Kathleen Kavalec

NOMINIMI

Kavalec u nominua nga presidenti Trump si ambasadore e SHBA-ve në Tiranë pas përfundimit të mandatit të diplomatit Lu. Por së fundmi mediat amerikane shkruajnë se emri i Kavalec, dikur zëvendës ndihmëssekretare e në Byronë e Çështjeve Evropiane të Departamentit të Shtetit është përfshirë në dosjen e debatueshme të Trump për zgjedhjet presidenciale.

"SMS për kryeministrin para vrasjes së vëllait"

Denoncimi te Berisha: Pas vrasjes, asnjë hetim nga prokuroria dhe policia

Një qytetar nga Shkodra ka denoncur prokurorinë dhe policinë se nuk po kryen asnjë hetim për vrasjen e vëllait të tij. Ngjarja sipas tij ka ndodhur para 1 jave, ndërkohë që ai i kishte paralajmëruar autoritetet që para 20 ditëve, por asnjë masë nuk ishte marrë për mbrojtjen e tij. Denoncimi i qytetarit u publikua dje nga ish-kryeministri Sali Berisha, i cili shkruan: "Asnjë hetim për vrasjen e paralajmëruar të Shkodrës! Qytetari dixhital denoncon: Asnjë hetim nga policia dhe prokuroria e Shkodrës për vrasjen e vëllait të tij! Ai kishte njoftuar policinë dy javë para se të ndodhte krimi". Në mesazhin drejtuar z.Berisha thuhet: "Desha t'ju informoj për ngjarjen



MESAZHI

"Më kanë vranë vëllanë para 1 javë dhe askush nga policia e prokuroria nuk ka ardhur të më pyesë kush ju ka vranë. 20 ditë para vrasjes i kam dërguar SMS kryeministrit se familja ime nuk ndihet e sigurt nga bandat tuaja", thuhet në denoncimin e qytetarit nga Shkodra.

e fundit në Shkodër. Më kanë vranë vëllanë para 1 jave dhe askush nga policia e prokuroria nuk ka ardhur të më pyesë kush ju

ka vranë. 20 ditë para vrasjes i kam dërguar SMS kryeministrit se familja ime nuk ndihet e sigurt nga bandat tuaja".

Në këtë cilësi, ajo është përgjegjëse për Rusinë dhe për Zyrën e Çështjeve Rajonale. Më parë ajo ka shërbyer

si drejtoreshë për Çështjet Ruse në të njëjtën Zyrë. Para kësaj ka qenë zëvendësdelegatë e Përhershme në Misionin e SHBA në UNESCO, në Paris (2010-2013). Në periudhën 2009-2010, zonja Kavalec ishte zëvendëskordinatore për Asistencën e SHBA për Evropën, Eurazinë dhe Azinë Qendrore. Ajo ka shërbyer më 2008-

2009 edhe si drejtoreshë Parandalimit të Konfliktit në Zyrën e Koordinimit për Rindërtim e Stabilizim. Detyrat jashtë vendit kanë përfshirë edhe ture në Ukrainë, Rusi, Rumanë e Brazil. Kavalec flet rrjedhshëm gjuhët frënge, rumune, ukrainase, ruse, spanjolle dhe portugeze, ndërsa ende nuk dihet nëse do të arrijë të flasë shqip me Tiranën.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 21.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com

Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuesit Petrit Sami Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:
"Aparamenti" me sipërfaqe 54 m², nr. i pasurisë 11/26+1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lajla "Gjakë Dog", Peshkopi, Dibër. Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1 600 000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

Në 6-mujorin e parë të këtij viti, Inspektori Shtetëror Teknik dhe Industrial ka vendosur 52 gjopa për shkelje të tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe të lëndëve djegëse, pajisjeve nën presion dhe instalimeve elektrike. Një ditë pas shpërthimit të një bombe gazi pranë një çerdheje në kryeqytet, "Scan" ka përpunuar të dhënat mujore të pub-



Shpërthimet e bombolave, ISHTI, në 6 muaj penalizohen 52 subjekte

likuara nga ky dikaster, ku rezultoi se aktiviteti i penalizimeve në 3-mujorin e dytë ka ardhur drejt rënies, duke qenë se në prill u penalizuan 14 subjekte, në maj 13 subjekte, ndërsa në qershor janë ndërmarrë 6 masa administrative. Ky dikaster duhet të intensifikojë kontrollin gjatë

muajve të verës për shkak të rrezikut të shkuar, si pasojë e temperaturave të larta, por këto hapa përgjithësisht ndërmerrin sa herë shënohen incidentet, sikurse ishte edhe ai i një viti më parë në Velipojë, ku për shkak të shpërthimit të bombolës së gazit në një kompleks turis-

tik u shënuan edhe viktime. Fatmirësisht, shpërthimi pranë çerdhes ndodhi gjatë orëve të para të mëngjesit, kur fëmijët dhe personeli nuk ishin të pranishëm. Temperaturat e larta rritin rrezikun për shpërthime, ndaj është e domosdoshme që të gjithë operatorët ekonomikë të mos

shfrytëzojnë pajisje nën presion pa i certifikuar teknikisht ISHTI dhe pa i pajisur me dokumentacionin teknik. Por, edhe konsumatorët familjarë duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm kur marrin bombolat e gazit, pasi duhet të sigurohen paraprakisht se bombolat të jenë të kolauduara, çka do të thotë që të jenë të certifikuara me të gjithë elementët teknikë të sigurisë.

Investimi 15 milionë euro për të ndërtuar mënyrën e re të llogaritjes

Ornela Manjani

Administrata tati more do të instalojë një sistem të ri teknologjik mbi kasat e bizneseve, i cili do të transmetojë çdo transakcion në kohë reale, drejtpërdrejt në serverin qendror të Tatimeve. Ministria e Financave ka hapur tenderin me vlerë rreth 1.9 miliardë lekë, ose rreth 15 milionë euro, për të kontraktuar kompaninë që do të instalojë sistemin. Sipas Financave, bizneset nuk do të kenë nevojë të blejnë kasa të reja, pasi sistemi do të instalojë në kasat aktuale dhe do të jetë pa pagesë. Sistemi aktual kompjuterik që përdorin Tatimet funksionon mbi bazë ditore. Çdo biznes, kur mbyll aktivitetin në fund të ditës, nxjerr manualisht xhiron ditore dhe e dërgon atë në serverin e Tatimeve. Por, me sistemin e ri, Financat thonë se transmetimi i të dhënave për çdo veprim që bën biznesi, shifje apo blerje, do të kryhet automatikisht në kohë reale dhe jo një herë në ditë. Aktualisht në Shqipëri mendohet se ka 160 mijë kasa, që përdoren nga bizneset. Ministria e Financave thotë se sistemi i ri ul kostot për administratën dhe mbyll shtigjet për evazion.

Ndryshimi i sistemit të kasave, sistem i ri faturimi

Ministria e Financave: 4 ndryshimet për bizneset



Foto ilustruese

sistem të ri teknologjik të faturimit. "Projekti i fiskalizimit synon krijimin e një sistemi 'online' të mbikëqyrjes në kohë reale të pajisjeve fiskale si për pagesat në cash për transakcionet biznes-konsumatorë, ashtu edhe për transakcionet biznes-biznes. Sistemi i ri, ndryshe nga ai aktual i ndërtuar në vitin 2010 do të lidhet edhe me modul

aktual të menaxhimit të riskut në tatime e më pas edhe në dogana, për të mundësuar një analizim më të thellë të përgjegjësiave fiskale të subjekteve dhe transakcioneve individuale të bizneseve", njofton Ministria e Financave. Aktualisht pajisjet fiskale transmetojnë të dhëna në sistemin qendror nëpërmjet GPRS, në fund të

ditës së punës, kur mbyllet kasa manualisht. Por sistemi aktual është i centralizuar, nuk identifikon

kuponin në kohë reale, por transmeton vetëm totalin e xhiros dhe numrin total të kuponëve të printuar nga çdo pajisje fiskale një herë në ditë. "Në të njëjtën kohë, me sistemin aktual mungon një analizë e detajuar për menaxhimin e riskut dhe kontrollin, nuk identifikohen faturat e lëshuara në mënyrë elektronike biznes-biznes dhe faturat me blloqe për shkak të mosdeklarimit të shitësit dhe blerësit, elemente këto të domosdoshme për efektivitetin e punës së administratës tatimore", vijon shpjegimet ministria. Projekti i fiskalizimit cilësohet si një tjetër hap i rëndësishëm në procesin e dixhitalizimit të administratës fiskale, në favor të

rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të efikasitetit të mbledhjes së të ardhurave dhe uljes së evazionit fiskal si dhe transformimit në të njëjtën kohë të marrëdhënies dhe bashkëpunimit mes administratës fiskale dhe tatimpaguesve.

SISTEMI I RI

Sistemi i ri, sipas Ministrisë së Financave, përveçse adreson këto mangësi, sjell edhe disa risi të rëndësishme. Është një sistem gjithëpërfshirës, që mbulon transakcionet biznes-konsumator (B2C) dhe biznes-biznes (B2B). Do të mundësojë monitorim më të mirë të të gjithë tatimpaguesve dhe auditimit të synuar, zvogëlimin e kostove administrative dhe rritjen e efikasitetit të Administratës Tatimore. Do të mundësojë plotësimin automatik të formularëve që tatimpaguesit duhet të dorëzojnë pranë autoriteteve tatimore (librat e shitjes dhe blerjes, apo të para-plotësorë fusha të caktuara të deklarimit të TVSH). Në transakcionet B2B do të jetë e mundur që blerësi të përcaktojë menjëherë nëse furnizuesi është me të vërtetë një pagues tatimor i TVSH-së.

NDRYSHIMET PËR BIZNESIN

Administrata Tatimore do të aplikojë së shpejti një

Kreditimi është joeficient

Studimi i BSH: Nuk ka mbështetur sektorët më produktivë

Shpërndarja e kredive ndërmjet sektorëve të ekonomisë shqiptare nuk ka qenë efiçente dhe në përpunje me zhvillimin ekonomik dhe rrezikun e kreditit të secilit sektor. Një studim i guvernatorit dhe disa ekspertëve të Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë ka treguar se për periudhën 2004-2014, shpërndarja sektoriale e kredisë nuk ka qenë plotësisht në përputhje me zhvillimet makroekonomike dhe situatën financiare të sektorëve të veçantë të ekonomisë. Në disa raste vërehet një mospërpunje kreditimit të sektorit dhe kontributit që ka ky sektor në rritjen ekonomike. Më konkretisht, për sektorin e industrisë dhe të shërbimeve është gjetur lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis rrezikut të kreditit dhe kreditimit, që

tregon se pavarësisht nivelit të lartë të kredive të këqija që kanë pasur këta sektorë, ata kanë vazhduar të financohen nga bankat. Ndërsa rezultatet e marra për sektorin e bujqësisë tregojnë që pavarësisht kontributit që ka sektori në vlerën e shtuar të ekonomisë, ky sektor akoma nuk ka gjetur mbështetje dhe durim nga bankat. Studimi vlerëson se sjellja joeficiente e shpërndarjes së kredisë midis sektorëve ka bërë që disa sektorë të jenë më të preferuar përkundër disa të tjerëve. Kjo ka bërë që bankat të sigurojnë mbrojtje për disa sektorë, në kundërshtim me forcat

e tregut, të cilat do të sillnin një shpërndarje më të mirë të burimeve në ekonomi dhe si rrjedhojë, një ristrukturim më të mirë të saj. Kjo sjellje pengon ecurinë e zhvillimit të sektorëve më produktivë dhe pasqyrojnë gjithashtu një problem të sjelljes së vetë bankave dhe motivimit të tyre për orientimin e kredisë së re nga e shkuara dhe jo nga tendencat aktuale të produktivitetit dhe rrezikut në sektorët e ekonomisë. Studimi nënvizon se një rishpërndarje joeficiente e kredisë pengon efikasitetin e politikës monetare dhe bëhet pengesë për rimëkëmbjen e ekonomisë.

Tel.: (+355-4) 4500015
4500016
4500017
Fax: (+355-4) 4500018

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNFPA office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: Driver	Tirana, Albania
Duty station: SC	
Type of Contract:	A minimum of three years work experience as a driver in an international organization, embassy of UN system with a safe driving record.
Work Experience:	
Language:	Good knowledge of English Language

Deadline for Application: 31 August, 2018 5:00 p.m.

Job Description: Available at the UNFPA site <http://albania.unfpa.org>

Interested and qualified candidates should submit the following documents:

- A letter of interest,
- An updated P11 Form,
- Copies of supporting documents, to the following address:

UNFPA Office
UN House Str. "Skenderbej"
Gurten Building, Second Floor
Tirana, Albania
albania.office@unfpa.org

Nota mesatare, kriter për kandidatët që do të ndjekin program të dytë studimi

Vendimi, miratohen datat e aplikimit për transferim studimesh

Ja në sa degë keni të drejtë të konkurroni

Voltiza Duro

Gjatë periudhës 3-14 shtator të këtij viti, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019 do të kenë mundësinë të kryejnë aplikimet pranë IAL-ve përkatëse. Shtesa pas kreut IV në udhëzimin NR. 18, ka hyrë në fuqi ditën e djeshme menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare. Sipas këtij vendimi në datat e sipërpërmendura mund të aplikojnë edhe të interesuarit që dëshirojnë të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë. Ndërkohë kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim. "Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo për transferim studimesh të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilat aplikojnë", theksohet në udhëzimin e miratuar e



3

SHTATOR, APLIKIMI

Prej datës 3 shtator të këtij viti, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019 do të kenë mundësinë të kryejnë aplikimet pranë IAL-ve përkatëse.

firmosur nga ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla. Sakaq, në këtë të fundit bëhet me dije se ata që aplikojnë për t'u pranuar si program i dytë apo për transferim studimesh në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare.

APLIKIMI PËR TRANSFERIM

Të interesuarit që dëshirojnë të kryejnë transferime, duhet të bëjnë kujdes pasi nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. "Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël

edhe lloj, të ndjekur nga kandidatit në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendëse apo të huaja", thuhet në udhëzim. Ndërkohë nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit

të parë Bachelor dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "master i shkencave". Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve duhet të paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve dhe dokumentacionin përkatës.

DOKUMENTACIONI:

- a) Kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet
- b) Plani i plotë i programit të studimit
- c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer,
- d) Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftësës së pjekurisë të shkollës së mesme.
- e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit
- f) Dy fotografi personale;
- g) Kopje e mandatpagesës.



ISHP: Nuk ka asnjë rast me virusin e Ethes së Nilit

Instituti i Shëndetit Publik ka njoftuar dhe se aktualisht nuk ka asnjë rast të sëmundjes virale Ethja e Nilit Perëndimor në Shqipëri. Sipas ISHP është bërë me dije më tej se prej dy vitesh në vendin tonë nuk ka asnjë rast të kësaj sëmundje, bazuar në të gjitha testimet e kryera për të gjitha rastet e dyshuara. "Qsh prej vitit 2011 në Shqipëri është vendosur survejanca për zbulimin e hershëm të Ethes së Nilit Perëndimor në të gjithë vendin dhe sidomos evidentimin e infeksioneve të sistemit nervor qendror të shkaktuar prej tij. Po ashtu janë përfunduar kapacitetet laboratorike të diagnozës, përfshi këtu dhe atë molekulare të kësaj sëmundje pranë laboratorit të virologjisë në ISHP", thekson ISHP në deklaratën për mediat. Kjo e fundit, gjithashtu, sqaron për opinion publik se për Shqipërinë është kryer edhe një vlerësim rrishtu ku janë përcaktuar zonat me rrishtu të lartë ku ka një survejanca dhe kontroll të përfunduar. Ndërkohë ISHP në bashkëpunim me Qendrën Europiane të Kontrollit të Sëmundjeve ka përcaktuar masat për të parandaluar përhapjen e kësaj sëmundjeje.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit po vijon në mënyrë intensive me masat dhe kontrollet ndaj subjekteve që cenojnë sigurinë ushqimore dhe shëndetin e konsumatorëve. Në kuadër të këtij aksioni, ditën e djeshme janë mbyllur tri lokale në zonën e Jalës, për shkak se kryenin veprimtari në kundërshtim me standardet e sigurisë ushqimore si dhe në kushte të rënda higjieno-sanitare. Gjatë inspeksionit të kryer në terrenin e zonave bregdetare nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, trupa inspektuese evidentoi 3 subjekte, dy me aktivitet "Restorant" dhe një "Fast Food" të cilët zhvillonin aktivitetin e tyre në

Gjohë prej 300 mijë lekësh për secilin subjekt AKU mbyll tri restorante në Jalë, kushte të rënda higjieno-sanitare

EMRAT E SUBJEKTEVE

"Ndaj subjekteve, restorant "Lavdoshi", restorant "Kapiteni" dhe fast food "Spiro Kreku" janë marrë masa administrative gjohë 300.000 lekë për secilin, si dhe bllokim i menjëhershëm i aktivitetit", - theksohet në njoftimin e AKU-së.

shkelje të rregullave të sigurisë ushqimore. "Ndaj subjekteve, restorant "Lavdoshi", restorant "Kapiteni" dhe fast food "Spiro Kreku" janë mar-

rë masa administrative gjohë 300.000 lekë për secilin si dhe bllokim i menjëhershëm i aktivitetit", - theksohet në njoftimin e AKU-së.

THIRRJA NDAJ BIZNESIVE

Ndërkohë vetëm një ditë më parë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore, i bëri thirrje edhe operatorëve të biznesit ushqimor (njësive të tregtimit e shërbimit) që të jenë të kujdesshëm në blerjen e lëndëve të para, produkte shtazore dhe jo shtazore duke kërkuar e marrë nga furni-



torët vetëm produkte me etiketë dhe të shoqëruara dokumentacion të plotë veterinar e fiskal - pasi është një detyrim ligjor i tyre përveçse përbën një masë tepër të rëndësishme për sigurinë ushqimore të klientëve të

tyre. Gjithashtu, AKU i bëri apel të gjithë qytetarëve që të denoncojnë çdo rast, çdo tentativë abuzimi, pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në info@aku.gov.al si dhe pranë portallit të bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam".

NJOFTIM ANKANDI
Me datë 17.08.2018 Permbareuesja Gjyqësore Emira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme e lloji **Ndërtëse, Kati I parë I përbërë nga dy dhoma banje, korridor, sallë dhe ballkon me sip. 123 m², me nr. radhori 1587 datë 23.11.1998 e ndodhur në Z.K.8592 L.Gj. "Naim Gjybegu" Rr. Sali Nivica/Shkoder. Çmimi fillësor për Shitjen në Ankand është në vlerën 5.707.200 lekë (Pesë milion e shtatëqind e shtatë mijë e dyqind lekë). Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) në ambientet e Zyres së Permbareueses Gjyqësore Emira Mhilli, me adresë L.Gj. "Qemal Stafa" Rr. "Don Bosko", dhe do të përfundojë me dt. 16.09.2018 ora 16:00 (me përfundimin e orarit zyrtar). **Personat e interesuar duhet të derdhin fillimisht shumën prej 10% të vlerës si garancitë në Bankën Raiffeisen-Dega Shkoder.** Ofertuesit të drejtohen pranë Zyres së Permbareueses Gjyqësore Emira Mhilli, ose të kontaktojnë nepërmjet Nr.tel:0692219253 ose adresës së emailit: emira.mhilli@hotmail.com**

NJOFTIM ANKANDI
Me datë 17.08.2018 Permbareuesja Gjyqësore Emira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme e lloji **Ndërtëse, Kati I parë I përbërë nga dy dhoma banje, korridor, sallë dhe ballkon me sip. 123 m², me nr. radhori 1587 datë 23.11.1998 e ndodhur në Z.K.8592 L.Gj. "Naim Gjybegu" Rr. Sali Nivica/Shkoder. Çmimi fillësor për Shitjen në Ankand është në vlerën 5.718.800 lekë (Kater milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë lekë). Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) në ambientet e Zyres së Permbareueses Gjyqësore Emira Mhilli, me adresë L.Gj. "Qemal Stafa" Rr. "Don Bosko", dhe do të përfundojë me dt. 16.09.2018 ora 16:00 (me përfundimin e orarit zyrtar). **Personat e interesuar duhet të derdhin fillimisht shumën prej 10% të vlerës si garancitë në Bankën Raiffeisen-Dega Shkoder.** Ofertuesit të drejtohen pranë Zyres së Permbareueses Gjyqësore Emira Mhilli, ose të kontaktojnë nepërmjet Nr.tel:0692219253 ose adresës së emailit: emira.mhilli@hotmail.com**

EPSA SHOOERIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:
1- "Pylit + Kullote" me sip. 280.000 m², Nr. hipotekor 168 datë 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.360.224 Euro. Ankand zhvillohet datë 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "1. Qemal", Pall. "Fratari", K.6, Tirane.
2- "Pylit + Kullote" me sip. 95.000 m², Nr. hipotekor 66 datë 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 1.140.076 Euro. Ankand zhvillohet datë 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "1. Qemal", Pall. "Fratari", K.6, Tirane.
Per çdo informacion kontaktoni në tel. 04 22627111 ose në www.epsa.al

BASHKIA E TIRANES

PUNIMET

Kryebashkiaku: Transformim total, qeveria bën legalizimin, bashkia urbanizimin

Erion Veliaj thirrje qytetarëve: Bëni regjistrimin e adresave

Rehabilitohet blloku i banimit në zonën e Selitës

Voltiza Duro

Bashkia e Tiranës po vijon me intensitet punën e saj për reabilitimin e rrugëve dhe blloqeve të banimit në kryeqytet edhe në këto ditë të fundit të verës. Dje ka përfunduar rikonstruksioni në zonën e Selitës, bllok i kufizuar nga rrugët "Hamdi Pepa", "Illa Dilo Sheperi", "Visarion Xhuvani", "Leka i Madh", duke zgjidhur përfundimisht problemin e infrastrukturës për banorët e ardhur kryesisht pas viteve '90. Kryebashkiaku Erion Veliaj inspektoi nga afër punimet e tha se zona e Selitës po urbanizohet, ndërkohë që iu bëri thirrje banorëve që të tregojnë kujdes në mirëmbajtjen e investimeve të bëra. "Rrikthehem në një zonë totalisht të transformuar. Këtu projekti nuk është vetëm logjistik: asfalt, llaç e tulla, por edhe pak në mentalitet. Kemi bashkuar energjitë: qeveria bën legalizimin, kurse bashkia urbanizimin. Pa legalizim nuk ka urbanizim; pra, është shumë e rëndësishme që fillimisht banorët të marrin hipotekën dhe në fund, pasi të kanë marrë pronën, ne ndërhyjmë në gjithë rrjetin rrugor, kanalizime dhe ndriçim", - u shpreh Veliaj. Më tej ky i fundit i ftoi qytetarët që të bashkëpunojnë për lirimin e hapësirave, të cilat pengojnë projektet zhvilluese. "Dua të falënderoj, së pari, banorët që kanë lënë pak nga territori i tyre i sapolegalizuar për t'ia dhënë bashkisë për trotuarat. Qytetarët duhet



Kryebashkiaku Erion Veliaj gjatë inspektimit në zonën e selitës

URBANIZIMI

"Kemi bashkuar energjitë: qeveria bën legalizimin, kurse bashkia urbanizimin. Pa legalizim nuk ka urbanizim; pra, është shumë e rëndësishme që fillimisht banorët të marrin hipotekën dhe në fund, pasi të kanë marrë pronën, ne ndërhyjmë në gjithë rrjetin rrugor, kanalizime dhe ndriçim", - u shpreh Veliaj.

APELI PËR REGJISTRIM

"Janë të gjithë qytetarë të Tiranës dhe duhet të regjistrohen këtu. Fakti që marrim taksa nga pjesa e vjetër e Njësisë 5 për t'i sjellë në zona ku vetëm së fundi, pas legalizimit, ka filluar të paguhet pak taksë prone, do të thotë se automatikisht Bashkia e Tiranës i ka privilegjuar", - tha Veliaj.

të kuptojnë se në fakt, trotuari nuk është i bashkisë, por një barrierë sigurie për ata dhe fëmijët e tyre. Kur kemi ardhur këtu ka qenë një monopati ngjashëm me një shteg dhish dhe rrëketë e lumenjve që vinin nga kodrat. Sot është dita me natën", - theksoi kreu i Bash-

kisë së Tiranës. Falë kësaj ndërhyrjeje, banorët e zonës së Selitës do të përfitojnë një bllok të ri banimi, me rrugë të shtruara, ndriçim e trotuare. **REGJISTRIMI I ADRESAVE**

Ndërkohë të gjithë qytetarët duhet të bëjnë regjistri-

min e adresës së saktë së vendbanimit, në mënyrë që zona të përfitojë nga shpërndarja më e mirë e fondeve dhe e investimeve. Ky ishte apeli që kryebashkiaku Erion Veliaj bëri ditën e djeshme ndaj banorëve të njësisë 5 në kryeqytet, gjatë inspektimit të punimeve të reja në

bllokun e Selitës. "I ftoj banorët të vijnë me regjistrimin në zonë. Sot janë të gjithë qytetarë të Tiranës dhe duhet të regjistrohen këtu. Fakti që marrim taksa nga pjesa e vjetër e Njësisë 5 për t'i sjellë në zona ku vetëm së fundi, pas legalizimit, ka filluar të paguhet pak taksë prone, do të thotë se automatikisht Bashkia e Tiranës i ka privilegjuar. Tani ka ardhur koha që edhe ata të sillen si qytetarë të Tiranës dhe të bëhen pjesë e kësaj bashkësie që paguan diçka modeste, por në fund fare kontribuon në të mirën e përbashkët", - tha Veliaj.



Kryeministri pro rikandidimit të Erion Veliaj për kryetar bashkie

Prej më shumë se dy javësh, kryeministri Edi Rama ka konfirmuar, gjatë takimit me të rinjtë e PS në Jalë, rikandidimin e Erion Veliaj në Bashkinë e Tiranës për një tjetër mandat. Në fjalën që mbajti para të rinjve, duke folur për ndryshimet që ka sjellë qeverisja e PS, Edi Rama është ndalur dhe në punët e bëra në Tiranë. Kryeministri tha se Tirana është në rrugën e duhur dhe po bëhet maksimumi, duke vlerësuar në këtë mënyrë dhe projektet që janë realizuar nga kryebashkiaku Veliaj. Duke folur për zgjedhjet e ardhshme vendore, Rama tha se PS do t'u besojë më shumë të rinjve në këshillat bashkiakë. "Vitin e ardhshëm të gjithë këshillat do t'i kemi 50 me 50 djem me vajza, gra me burra. Kurse për urbanizimin ajo është një sfidë në vazhdim. Janë bërë dëme të jashtëzakonshme në vite të tëra. Nuk është e lehtë. Megjithatë, besoj që Tirana është në rrugën e duhur. Në Tiranë po bëhet maksimumi. Edhe në disa bashki të tjera që e kanë këtë plagë shumë të madhe unë besoj që po bëhet një punë shumë e madhe", - tha Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 7.800.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 11 Shtator 2018, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

S4J
 Alltisi për Punë / Skills for Jobs

INVITATION TO BID

Swisscontact is an independent Swiss foundation promoting economic, social, and environmental development. Swisscontact's objective is to open up pathways out of poverty for people in developing countries through broad-based economic development. In its various projects Swisscontact facilitates access to skills development programmes, fosters competitive entrepreneurship, creates access to local financial services, and promotes sustainable use of resources.

In the framework of the Skills for Jobs project, Swisscontact seeks to realize the procurement object: "Purchase of electronic equipment and whiteboards", for the operation of Career Centers, the implementation of the School Management System, the application of combined learning and the improvement of IT infrastructure in partner schools.

Swisscontact, invites interested candidates to bid for the realization of the procurement object, according to the equipment list.
 For more detailed information, please visit the following website:
<https://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html>

"Në 8 muajt e 2018-ës janë sekuestruar mbi 1 ton lëndë narkotike"

Gazeta "Kathimerini": Droga që vjen nga Shqipëria po "mbyt" Epirin

"Gjatë 2 viteve të fundit ka pasur një rritje në masën 232 për qind të rasteve të trafikut"

GREQI

Droga, kryesisht hashashi që vjen nga Shqipëria, 'mbyt' Epirin". Ky është titulli i djeshëm i një artikulli të një prej gazetave më të mëdha greke, "Kathimerini". Përmes një shkrimi, gazeta në fjalë ka nxjerrë shifrat që u referohen sasive të mëdha të drogës së kapura në territorin e tyre, origjina e të cilave ishte nga Shqipëria. E përditshme greke cilëson Shqipërinë si furnizuesin kryesor me drogë për të gjithë Europën. Në shkrim thuhet se përgjatë dy viteve të fundit ka pasur një rritje në masën 232% të rasteve të trafikut të të gjitha llojeve të drogave që janë zbuluar nga operacionet e përditshme përgjatë kufirit greko-shqiptarë. Sipas një raporti të policisë greke, thuhet se grupet kriminale furnizojnë me sasi të mëdha kanabisi shtetin helen, një pjesë të Ballkanit, Europën, Italinë apo dhe Turqinë. Gjithashtu, në shkrimin e gazetës "Kathimerini" thuhet se në vitin 2016, policia greke ka sekuestruar në zonën e Epirit 2.7 tonë hashash, ndërsa në vitin 2017 sasia e sekuestruar ishte 9.2 tonë. Ndërkohë, deri më tani për vitin 2018 janë kapur 961 kg drogë në Janinë dhe 300 kg në zonën e Thesprotisë, ndërsa nga aksionet janë arrestuar 306 persona, kryesisht shqiptarë. Një pjesë e operacioneve realizon në kufirin e gjelbër, por nëse të dyshuarit kalojnë prefekturën e Janinës, atëherë policia mobilizohet kryesisht në Artë, ku përmes postblloqeve arrestohen në flagrancë trans-

232

PËR QIND
Në shkrim thuhet se përgjatë dy viteve të fundit ka pasur një rritje në masën 232% të rasteve të trafikut të të gjitha llojeve të drogave që janë zbuluar nga operacionet e përditshme përgjatë kufirit greko-shqiptar. Sipas një raporti të policisë greke, thuhet se grupet kriminale furnizojnë me sasi të mëdha kanabisi shtetin helen, një pjesë të Ballkanit, Europën, Italinë apo dhe Turqinë.

portuesit e drogës. Vetë trafikantët kanë si synim që ta fshihin drogën në vende të ndryshme, ndoshta të cilësuar si më të vështira në dekadat e fundit. Por nuk janë vetëm transportuesit



shqiptarë, që në çdo mënyrë përpigjen të kalojnë kryesisht hashash nga kufiri dhe pastaj ta kanalizojnë atë në Greqi, por edhe kultivuesit dhe trafikantët grekë, të cilët përpigjen që ta kultivojnë drogën në shtëpi dhe më pas ta shesin. Aktualisht, në ndihmë të këtyre operacioneve, referuar shkrimit, ka ardhur në ndihmë të policisë greke edhe "Frontex" për kontrollin në kufirin greko-shqiptar me inspektimeve të plota.

DROGA E SEKUESTRUAR NË 3 VITET E FUNDIT

1. Në vitin 2016, policia greke ka sekuestruar në zonën e Epirit 2.7 tonë hashash.
2. Në vitin 2017 sasia e sekuestruar ishte 9.2 tonë.
3. Në 8 muajt e vitit 2018 janë sekuestruar 961 kg drogë në Janinë dhe 300 kg në zonën e Thesprotisë.
4. Në aksionet e policisë greke janë arrestuar 306 persona, kryesisht shqiptarë.

SHKURT

Shpërndante drogë në qytet, bie në pranga 26-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka vënë në pranga një 26-vjeçar, pasi akuzohet për shpërndarje të lëndëve narkotike. Burime zyrtare bëjnë me dije se bëhet fjalë për shtetasin me inicialet R.H., banues në lagjen "Aqif Pasha". Mësohet se i riu po transportonte një sasi lëndë narkotike për ta shitur në doza. Sipas bluve, gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin e tij në lagjen "5 Maji" u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një sasi prej 289 gr kanabis. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Mbytet aksidentalisht në liqenin e Banjës vajza 11-vjeçare

GRAMSH - Një 11-vjeçare është mbytur aksidentalisht në liqenin e hidrocentralit të Banjës në Gramsh. Ngjarja ka ndodhur pasditen e së premtes dhe viktima është Andja Toçila, banuese në fshatin Trashovicë të këtij rrethi. Sipas burimeve policore, e mitura ishte nën shoqërinë e të atit në momentin që i ka rrëshqitur këmba dhe ka rënë në ujë. Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e policisë, grupi hetimor dhe palombarët, ku kanë bërë të mundur gjetjen dhe nxjerrjen e trupit të pajetë. Ndërkaq, grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

I riu merr lajmin e mirë për punë në këtë institucion

Shpëtoi dy vajzat binjake nga mbytja në lumë, Bashkia certifikatë mirënjohje për Admir Murataj



Admir Murataj me kryebashkiakun Subashi

FIER - Admir Murataj, i cili pak ditë më parë u hodh në lumin Seman për të shpëtuar vajzat binjake që po tentoj të mbyteshin nga nëna e tyre Rudina Kishta, dje ka marrë certifikatë mirënjohje nga Bashkia e Fierit. I riu, përmes ndërmjetësimit që bëri 'News24' zhvilloi një takim me kryetarin e Bashkisë, Armando Subashi. Ky i fundit i dha Muratit një certifikatë mirënjohjeje për aktin human dhe vlerat qytetare. Por jo vetëm kaq, për të riun e papunë, bashkia e Fierit ka menduar që t'i ofrojë atij një vend pune në këtë institucion.

Në një intervistë për "News24" dhe "Gazeta Shqiptare" Murati tregoi se ishte i papunë, pavarësisht se kishte mbaruar shkollën për elektricist. Ai tha se atë ditë kur ndodhi ngjarja kishte shkuar në lumë për të peshkuar, ndërsa ishte përballur me

skenenë horror, ku 42-vjeçarja po tentonte të mbyste dy vajzat e saj 6-vjeçare, pasi i kishte vënë zjarrin banesës së bashkëjetuesit. "U hodha drejt në lumë dhe notova

në drejtim të tyre. Njërin nga vajzat e kam nxjerrë nga lumi pa ndjenja dhe i kam bërë frymëmarrje artificiale. Në lum u hodh dhe një peshkatar tjetër që ndod-

hej aty për të shpëtuar nënën dhe dy fëmijët e saj. U ndjeva i shokuar, pasi vajzat ishin si engjëj dhe shumë të bukura", tha "heroi nga Fieri". Ndërkohë, Admir Murataj pohoi se pasi doli grujat në breg tentoi t'i mbyste me thonj vajzat e saj dhe pse aty mbërriti policia. Vetëm dy ditë më parë Gjykata e Shkallës së Parë e Fierit vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Rudina Kishtës, e cila akuzohet se dogji shtëpinë e bashkëjetuesit të saj, Ardian Gjika e më pas tentoi të mbyste dhe dy vajzat. E pandehura shokoi me deklaratën e saj në sallën e gjyqit. Ajo tha se "vajzat do t'i mbyssa je janë të mia"



Hynë ilegalisht në Shqipëri, ndalohen 23 emigrantë nga Lindja e Mesme

DEVOLL - Shërbimet e policisë kufitare në Devoll kanë ndaluar pasditen e djeshme 23 emigrantë nga vendet e Lindjes së Mesme, të cilët kishin hyrë ilegalisht në territorin shqiptar. Emigrantët u ndaluan në qytetin e Bilishtit teksa ishin duke udhëtuar me autobus dhe pas kryerjes se procedurave në Drejtorinë e Kufirit, janë dërguar në qendrën e azilkerkuesve në Babrru të Tiranës. Ndërkaq, dyshohet se emigrantët janë nga Siria dhe kanë hyrë nga pika kufitare e Kapshiticës. Nuk dihet nëse destinacioni i tyre ka qenë Shqipëria apo e kanë përdorur vendin tonë si rrugë kalimi për në vendet e BE-së. Në 3 treditët e fundit, janë kapur 56 refugjatë në zonën e Devollit.

Drejtori i Policisë Rrugore: Grupe teknike, për të verifikuar strukturat e urave

Frika nga rrëzimi i urës në Xhenova, Tola: Kemi nisur kontrollin e urave në Shqipëri

"Do monitorojmë tejkalimin e ngarkesave nga mjetet"

Pas tragjisë në Xhenova, Policia e Shtetit ka filluar inspektimin e urave në vendin tonë për të parë gjendjen e tyre, strukturat dhe elementët e sigurisë. Në një konferencë për mediat, drejtori i Policisë Rrugore, Mithat Tola u kërkoi drejtuesve të mjeteve të respektojnë edhe sinjalistikat dhe peshën e automjeteve për kalimin mbi urë. Drejtori i Policisë Rrugore, Mithat Tola tha se janë marrë disa masa dhe nisi inspektimi i peshës së lejuar të mjeteve mbi ura, po ashtu edhe gjendjen e këtyre strukturave dhe të elementeve të sigurisë. "Nisur nga ngjarja tragjike, rrëzimi i urës në Xhenova të Italisë ku humbën jetën 39 persona ka Policia Rrugore ka filluar inspektimin e sistemeve të sinjalizimit vertikal - horizontal mbi tregimin e peshës së lejuar të




Drejtori i Policisë Rrugore, Mithat Tola

mjeteve në të gjitha urat e vendit si dhe do të marrë pjesë në vijim në përbërje të grupeve teknike të punës dhe të inspektimit të Ministrisë së Infrastruktura për të verifikuar gjendjen e të gjitha strukturave dhe elementeve të sigurisë të këtyre urave. Në bashkëpunim me aktorë të tjerë të ngarkuar me ligj për menaxhimin e elementeve të sigurisë në këto infrastruktura, shërbimi i Policisë Rrugore do të

monitorojë në mënyrë të rregullt tejkalimin e peshave dhe ngarkesave nga mjetet për të shmangur dëmtimet dhe për të bërë që ata të respektojnë ligjin duke prodhuar më shumë siguri për të gjithë", u shpreh Tola. Gjithashtu, Tola u bëri thirrje drejtuesve të automjeteve të kenë kujdes në timon, pasi fluksi i qarkullimit është rrezik për aksidente. Gjithashtu, kreu i Policisë Rrugore paralajmëroi

kontrolle të shpejtësive në mënyrë elektronike pëmes sistemit radar. Por, përtej përforcimeve nga ana e qarkullimit rrugor, në Shqipëri dhe shtete si Bullgaria, Franca, Gjermania dhe Zvicra janë angazhuar të bëjnë inspektime të gjendjes së urave dhe rindërtimin e tyre në rast amortizimi. Të paktën pesë ura, ajo e Vorës, Kukësit, Milotit, Tapizës dhe Dragotit paraqesin rrezikshmëri. Tola renditi edhe akset më të ngarkuara me qarkullim jetësh dhe trafik, ku Saranda rezultonte qarku më i prekur. Në përfundim të konferencës, Tola u bëri thirrje qytetarëve të denoncojnë çdo abuzim që konstatojnë në rrugë, përfshi manovrat e gabuara, parakalimet e gabuara, shpejtësi të normave si dhe zënien e korsive nga shoferë të pa-përgjegjshëm.



Hajnaj inspekton pikat kufitare: Performancë më të lartë nga policia

Zëvendës drejtoresha e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Aida Hajnaj, ka inspektuar pikat e kalimit kufitar në jug të vendit për të parë zbatimin e masave shtesë për sezonin veror 2018. Hajnaj gjatë inspektimit në këto pika ka konstatuar se masat shtesë për një sezon turistik veror sa më të sigurt po zbatohen me korrektësi nga ana e punonjësve të policisë dhe ka theksuar se zbatimi i këtyre masave ka sjellë më shumë siguri për pushuesit në të gjitha plazhet e vendit. Aida Hajnaj ka kërkuar që ky angazhim dhe përkushtim të vijojë më me intensitet deri në përmbyllje të sezonit, si dhe ka kërkuar nga punonjësit e policisë performancë më të lartë në drejtim të shërbimit, por edhe të etikës dhe sjelljes, kundrejt qytetarëve dhe uniformës që ata përfaqësojnë. Gjatë një interviste për mediat, Hajnaj ka theksuar se gjatë sezonit turistik nëpërmjet Qafë- Botës kanë hyrë rreth 105 mijë shtetas, ku 73 mijë janë shtetas të huaj si dhe nga porti i Sarandës kanë hyrë rreth 125 mijë shtetas, ku rreth 104 mijë janë shtetas të huaj. Gjithashtu, Hajnaj ka vlerësuar bashkëpunimin me rojën bregdetare dhe kullat e vrojtimit për dhënie ndihmë pushuesve që u rrezikohet jeta nga mbytja në det, si dhe bashkëpunimin me homologët për parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme. "Policia e Shtetit po monitoron çdo ditë zbatimin e masave të sezonit turistik në Pikat e Kalimit Kufitar edhe në plazhe. Në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar, si në hyrje dhe në dalje janë shtuar sportelet edhe burimet njerëzore, me punonjës të Policisë Kufitare, me qëllimin e vetëm për një menaxhim sa më të mirë të lëvizjes në hyrje dhe në dalje të shtetasve dhe për një shërbim sa më të kulturuar", tha Hajnaj.



Save the Children

VACANCY ANNOUNCEMENT

Save the Children is the world's leading independent organization for children. We work in 120 countries. We save children's lives; we fight for their rights; we help them fulfill their potential. We work together, with our partners, to inspire breakthroughs in the way the world treats children and to achieve immediate and lasting change in their lives. We have been working in Albania since 1999. We are looking for dynamic staff to join our team.

Save the Children is recruiting for motivated and experienced staff for the project "Civic engagement for a functional judiciary system and access to justice in Albania"

Post title: Sub-Grant Coordinator
Application dateline: 20 August 2018, 4:00pm

Candidates that meet below qualifications and experience are encouraged to apply.

- A Bachelor degree in relevant subject from an accredited University in Business Administration, Finance or Law. Master in relevant subject.
- Minimum 5 years of relevant work experience, preferably in an NGO/international organization.
- Previous experience with PRAG/EU projects.
- Excellent computer skills including: Microsoft Word, advanced Excel, Internet, Email and Power Point and demonstrated computer literacy & database management.
- Willing to travel in the field.
- Experience in working with partner organisations.
- Understanding and commitment to the aims and objectives of Save the Children and children's rights in Albania

You will find more information for the Job Description on the web page <https://albania.savethechildren.net/jobs>. Interested candidates should submit the following within the application dateline:

- 1- Cover letter clearly explaining your motivation for applying your motivation for applying for the position and how you meet the position criteria;
- 2- Detailed CV;
- 3- Copy of their Diploma.

Application should be sent by email to the address below. Please clearly specify in the subject line or in the cover letter the position you are applying for.

E-mail: info.albania@savethechildren.org

***only short listed candidates will be informed.**

Save the Children in Albania
Rr. Komuna e Parisit, Lagja 8, Pallati 1 Maj,
Via "Lumi" P.O. Box 8185, Abanasi
Phone: +354 4 2261840/+354 42261929/+355 4 2268227
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: albania.savethechildren.net

Save the Children International
St Vincent House
30 Orange Street
London WC2H 7PH
United Kingdom

A company limited by guarantee.
Registered charity number 1076822
Registered company number 3732267
Registered in England and Wales
www.savethechildren.org

Telephone +44 (0) 20 3272 0300
Fax +44 (0) 20 3272 0301
info@savethechildren.org
www.savethechildren.net



Save the Children

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize -për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët. Ne jemi duke kërkuar staf të kualifikuar dhe aktiv për t'u bashkuar me ekipin tonë.

Save the Children do të rekrutojë staf të motivuar dhe me përvojë për projektin "Përfshirja e Shoqërisë Civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri"

Titulli i pozicionit: Koordinator i Grantëve
Afati i fundit për aplikim: 20 Gusht 2018, 16:00

Kandidatët që kanë kualifikimet dhe përvojën, e përkrahur si më poshtë, inkurajohen të aplikojnë.

- Diplomë Bachelor në Administrim Biznes, Financë ose Juridik. Diplomë Master në një nga këto degë përbën avantazh.
- Minimumi 5 vjet përvojë pune kryesisht në OJF/organizata ndërkombëtare.
- Përvojat e mëparshme me projektet PRAG / BE.
- Afërsi të shkëlqyera kompjuterike, duke përfshirë: Microsoft Word, Excel të avancuar, Internet, Email dhe Power Point dhe menaxhim të dhënash.
- Të gatshëm për të udhëtuar në terren.
- Përvojë pune me organizatat partnere
- Të kuptuar dhe përkushtim ndaj qëllimeve dhe objektivave të Save the Children dhe të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

Ju do të gjeni më shumë informacion për Përkrahimin e Punës në faqen e internetit <https://albania.savethechildren.net/jobs>

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë, brenda datës 20 Gusht 2018:

- 1- Letër motivimi ku shpjegoni qartë arsyen tuaj për aplikim dhe mënyrën se si i përbushni kriteret;
- 2- CV e detajuar;
- 3- Kopje të Diplomës tuaj.

Aplikimi duhet të dërgohet në anglisht me email në adresën e mëposhtme. Ju lutem specifikoni qartë pozicionin për të cilin po aplikoni.

E-mail: info.albania@savethechildren.org
***vetëm kandidatët e përzgjedhur do kontaktohen**

Save the Children in Albania
Rr. Komuna e Parisit, Lagja 8, Pallati 1 Maj,
Via "Lumi" P.O. Box 8185, Abanasi
Phone: +354 4 2261840/+354 42261929/+355 4 2268227
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: albania.savethechildren.net

Save the Children International
St Vincent House
30 Orange Street
London WC2H 7PH
United Kingdom

A company limited by guarantee.
Registered charity number 1076822
Registered company number 3732267
Registered in England and Wales
www.savethechildren.org

Telephone +44 (0) 20 3272 0300
Fax +44 (0) 20 3272 0301
info@savethechildren.org
www.savethechildren.net

DEBATI

Vulosja e librave që u shkruan në diktaturë, Ymeri: Është lloj censure

Fatmira Nikolli

S hënjimi, siglimi, apo vulosja e veprave të artit të krijuara në diktaturë si për të thënë se ato përçojnë propagandën e kohës, nuk bën asgjë më shumë se të na kthejë në kohën e diktatit, daciaboave dhe dhunës.

Për botuesin e "Diturisë", Petrit Ymeri, dekomunistizimi në këtë formë, me komisione, ligje e akte nënligjore veçse imiton të shkuarën duke dashur të zbehtë ndikimin e saj në shoqërinë e ditëve tona.

"Mendoj se gjithsesi kjo mund të japë efekt të kundërt. Duke i vënë 'etiketa' do fillojnë të kërkohen e të lexohen më shumë librat me 'pullë'. Nuk jam për këto forma, sepse gjykoj që kjo është një lloj diktature e re, do të thosha; është në një farë mënyre si ta dënosh veprën artistike, ta dënosh veprën letrare me të tilla forma", thotë Ymeri në një prononcim të kërkuar nga "Gazeta Shqiptare" për çështjen.

Prej muajsh Partia Demokratike ka hartuar një draft ligj që ka të bëjë ndalimin e simboleve komuniste kryesisht. Drafti i hartuar i është çuar për mendim nga pikëpamja historike dhe juridike Fondacionit gjerman "Conrad Adenauer". Siç ka raportuar "Gazeta Shqiptare" që në maj të këtij viti, një grup pune i përbërë nga Enkelejd Alibeaj, Erald Kapri e të tjerë kanë bërë gati një dokument prej 12 faqesh, që ka në fokus ndalimin me ligj të simboleve të diktaturës dhe portretet e ish-udhëheqësve të saj. Së fundmi, Enkelejd Alibeaj, nënkryetar i grupit parlamentar të PD ka bërë me dije se në lidhje me propagandën, Partia Demokratike synon të rregullojë me ligj edhe çështjet që kanë të bëjnë me artin e realizmit socialist. Në dokumentin që është ende draft dhe pret propozime e rishikime, mes të tjerash vihet në dukje edhe se duhet "të ndalohen të gjitha veprat intelektuale apo artistike, të cilat kanë propagandë komuniste, një ndër to do të jenë dhe filmat e shfaqur gjatë periudhës së diktaturës hoxhiste.

Do të detyrohet Ministria e Arsimit që të rishikojë kurrikulën.

• Të gjitha librat apo propaganda të publikohen nëpër muzetë, për çështje kërkimore shkencore, por jo



Petrit Ymeri

për çështje publike, siç ndodh në ditët e sotme. Në rast se dikush tenton t'i përdorë, do të dënohet me gjobë.

Ajo që po përpigjet të bëjë Partia Demokratike është vendosja e një shënimi tek çdo film apo libër për të shpjeguar diktaturën komuniste, pa përjashtuar asnjë film apo libër.

Më poshtë, mendimi i plotë i botuesit të "Diturisë", Petrit Ymeri.

PETRIT YMERI

Duke e ndjekur këtë diskutim, mendimi i parë që më erdhi ishte se politika kërkon të tërheqë vëmendjen e publikut me probleme, që, sipas meje, nuk i interesojnë një publiku të gjerë, përballë atyre tejet me të rëndësishme me të cilat përballemi të gjithë. I tillë është edhe ky që hidhet në diskutim, pra përballja me dekomunistizimin e artit apo të letërsisë.

Po jap një mendim për atë sa kam dëgjuar, sepse ende nuk kemi parë një propozim të shkruar, konkret, por më shumë janë opinione që vijnë nëpërmjet shtypit,

Propozimi i PD për dekomunistizimin, botuesi: Lexuesit nuk janë injorantë

ndonjëherë edhe të transformuara.

Gjithsesi, për atë sa jam informuar, këto kërkesa për etiketa apo për guida shpjeguese që propozohen t'u vihen librave a filmave, më duken paralele me ato muzetë qesharakë, që janë bërë në Tiranë a gjetkë, me bunkerë me gjethe apo pa gjethe. Të gjithë krahët e politikës përpigjet të tërheqin vëmendjen e publikut me flamurin e dekomunistizimit, a thua se çdo gjë tjetër na vete vaj.

Mendimi im është që të mos i trajtojmë lexuesit apo spektatorët si injorantë apo budallenj, por t'i lemë të lirë të mendojnë e të vlerësojnë, ta lëmë ririnë të gjykojë vetë, sepse besoj që për ririnë bëhet fjalë në radhë të parë. Të rinjtë janë vërtet të rinj, por nuk janë njerëz me kufizime mendore. Ata jetojnë në shoqëri dhe kanë të gjitha

diçka, për t'i dhënë besueshmëri, thonë që po ia dërgojnë një fondacioni a institucioni të huaj, po ia çojnë filan komisioni jashtë, ia çojnë Brukselit a Venecias (dhe më pas i bëjnë siç i duan vetë!). Këto janë gjëra që mund të diskutohen edhe me partnerë të huaj, nuk është problem, por nuk është argument bindës të themi që "e kemi diskutuar edhe me të huajt!".

Vetëm me debate të qeta kulturore e historike mund të vlerësohen veprat artistike, por jo duke i "titruar" veprat politikisht. Pa folur pastaj që kjo mund të japë efekt të kundërt. Duke i vënë 'etiketa' ndofta do fillojnë të kërkohen e të lexohen më shumë librat me "pullë". Nuk jam për këto forma, sepse gjykoj që kjo është një lloj censure; në një farë mënyre është si ta dënosh veprën artistike, ta dënosh veprën letrare me të tilla for-

PROPOZIMI

Enkelejd Alibeaj, nënkryetar i grupit parlamentar të PD ka bërë me dije se në lidhje me propagandën, Partia Demokratike synon të rregullojë me ligj edhe çështjet që kanë të bëjnë me artin e realizmit socialist. Në dokumentin që është ende draft dhe pret propozime e rishikime, mes të tjerash vihet në dukje edhe se duhet "të ndalohen të gjitha veprat intelektuale apo artistike, të cilat kanë propagandë komuniste, një ndër to do të jenë dhe filmat e shfaqur gjatë periudhës së diktaturës hoxhiste.




Enkelejd Alibeaj

ma. Mendoj se lexuesi është në gjendje të orientohet kur e lexon një vepër dhe arrin të kuptojë edhe veprën letrare apo artistike, por edhe të vendosur në kohë. Historia e kulturës dhe e letërsisë botërore ka me

mijëra shembuj të tillë të veprave artistike që përcjellin mendime a ide që nuk kanë përkuar me ato të periudhëve të mëpastajme, por nuk janë shoqëruar me pulla apo etiketa. Duhet kuptuar dhe duhet thënë se çdo vepër letrare apo edhe personazh i veprës, mban vulën e kohës kur u shkrua, pasqyron dhe reflekton një periudhë të caktuar. Edhe kjo përbën një vlerë. Vetëm autori mund ta ndryshojë veprën e tij, letrare apo artistike. Askush nuk e ndalon, ndërkaq, institucionin botues apo të shfaqjes artistike, të vërë shënimin "idetë e librit/filmit/shfaqjes teatrale etj. janë të autorit përkatës".

Unë nuk jam njohës i praktikave të huaja për raste të ngjashme. Çdo vend mendoj që ka përvojat e veta, zgjidhjet e veta. Por mendoj se këto nuk janë punë e komisioneve politike. Nuk mund t'i ndryshojnë komisionet politike apo t'i orientojnë veprat artistike. Nëse i ndryshojnë komisionet, atëherë kthehemi në praktikën e dhunës, të censurës, nëpërmjet akteve ligjore a nënligjore. Ta lëmë mendimin e lirë, opinionin e lirë.





BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 623


SUPLEMENTI I PERJAVSHEM
E shtunë 18 gusht 2017

GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela ALIAJ

**MANUSHI ZEVENDESON
DUDUSHIN, KUSH JANE EMISIONET
E REJA QE DO DREJTOJNE**



**HYRJET E REJA DHE LARGIMET NGA TCH,
SURPRIZAT QE NA PRESIN NE SHTATOR**



VIPAT NE PLAZH

**RITA ORA "NXJERR"
GJOKSIN, DUA LIPA SHPENZON
SHIFRA MARRAMENDESE VETEM
PER PUSHIME**



"BIG BROTHER VIP" XHENSILA PERE:

*Do të konkurroja
çift me një femër*

*E 'kapën mat' me të 'fejuarin', reagon ish-banorja e
'Big Brother': Jam prej kohësh single*



ROZANA RADI

**Poston foto me njeriun e
zemrës, moderatorja e "Boom"
shfaqet e dashuruar në Itali**

*Prej 7 vitesh bashkëjetesë, kush
është 'gjysma tjetër' e këngëtares*



Prej 7 vitesh bashkëjetesë, kush është 'gjysma tjetër' e këngëtares

Pushimet romantike të Rozana Radit, poston foto me njeriun e zemrës

Më në fund e bën publike, moderatorja e "Boom" shfaqet e dashuruar në Itali



publikun detaje nga lidhja e saj 6-vjeçare me djalin që i ka rrëmbyer zemrën. Teksa ka qenë e ftuar në emisionin 'Rudina', Rozana ka folur për partnerin dhe bashkëjetesën. Këngëtarja ka pohuar se ka disa vite që bashkëjeton me të dashurin e saj, oficer të Policisë Gjyqësore. "Po, ai është shoku im, është e vërtetë. Ne kemi disa vite që bashkëjetojmë. Ai punon në prokurori, por nuk është prokuror. Është oficer i policisë gjyqësore. Do të doja të mos e vazhdoja më. Ne e duam njëri-tjetrin. Jemi shumë mirë bashkë. Unë jam e lumtur. Kam gjetur veten. Lumturia është një fjalë e madhe, por jam njeri me këmbë në tokë. Kam gjetur veten", pohon Rozana. Nga ana tjetër Rozi nuk iu shmang dot pyetjes se çfarë e tërhoqi më shumë tek partneri i saj. "Ai ka një sens humori që i ngjet babit tim, ka karakterin e tim eti. Kjo është edhe gjëja që më ka bërë për vete", theksoi ajo. Rozana u ndal tek fakti nëse ka plane për të ardhmen. "Unë propozim nuk kam marrë, por më pëlqen edhe kështu," thotë ajo. Ndërsa një tjetër moment interesant ka qenë kur ajo ka

thënë se ka thyer një pasqyrë dhe me shaka ka shtuar se kushedi se kur do të martohej duke qenë se sipas besëtytnive e shoqëronin edhe 7 vite ters. Kjo ishte vetëm një shaka nga ana e këngëtares për të tërhequr vëmendjen nga lidhja e saj me policin e prokurorisë. Në fund të fundit e rëndësishme është që çifti ndihet mirë dhe Rozi ka gjetur gjysmën e saj! That's amore!(Kjo është dashuria)

Pamela Aliaj

Tashmë prej 6 vitesh këngëtarja e njohur, Rozana Radi, është në një lidhje me oficerin e Policisë Gjyqësore të Tiranës, Shpëtim Karakushi. Edhe pse ajo është treguar gjithnjë e rezervuar lidhur me jetën e saj private, lidhja e tyre u bë publike vetëm dy vjet më parë, teksa ata u shfaqën krah njëri-tjetrit në Pallatin e Kongreseve, kur Rozana fitoi çmimin e parë të Këngës Magjike. Ndërkohë që gjatë një interviste, Rozana ka treguar se do të martohej së shpejti edhe pse nuk ka caktuar

një datë të saktë. Ndonëse nuk i ka publikuar fytyrën Rozi shfaqet tejte e lumtur gjersa mban dorën e tij. Ky detaj pikasi edhe në një nga postimet e fundit të hedhura në faqen e saj në 'Instagram'. Pas pushimeve të veçanta të kaluara me familjen e saj, jashtë Shqipërisë, këngëtarja duket se nuk ka përfunduar me kaq relaksin për këtë verë. Nuk kishin se si të mungonin edhe pushimet me bashkëjetuesin e saj në një nga vendlindjet e dashurisë, Itali. Ajo që ka bërë më tepër përshtypje është pikërisht se ndryshe nga gjithë herët e tjera ku ajo nuk ka dashur të postojë as edhe një foto me të,

kësaj radhe, parapëlqeu të nxirrte në foto vetëm dorën e tij të cilën ajo është duke e shtrenguar. Me të njëjtin titull pothuajse në çdo foto, Rozana shkruan: Kjo është dashuria! Më fol për dashurinë! Etj. Pra, duket se këngëtarja është duke kaluar pushime vërtet unike dhe shumë romantike pranë njeriut të saj të zemrës. Ndërkohë që për herë të parë, lidhur me personin e saj të zemrës, Rozana Radi është shprehur para dy viteve në një intervistë. Këngëtarja ka ndarë me


Edi Manushi zëvendëson Alban Dudushin, cilat janë emisionet e reja që do drejtojnë

Hyrjet e reja dhe largimet nga TCH, ja surprizat që na presin në shtator

Ikën Anjeza Maja, zbulohet emri i moderatores së re të "Në shtëpinë tonë"

Pamela Aliaj

Ndërkohë që jemi ende në sezonin e nxehtë të verës, jemi edhe në një valë të madhe ndryshimesh të cilat presim t'i shohim të gjitha në shtator, atëherë kur fillon për të gjithë puna! Ndërsa lart e poshtë është përfolur për largime dhe rikthime të reja, ne kësaj radhe do të përqendrohemi në ndryshimet që do të pësojë televizioni i Top Chanel. Sipas burimeve të "BlueTooth" të "Gazeta Shqiptare" një figurë e njohur do t'i rikthehet sërish këtij televizioni. Po flasim pikërisht për moderatoren Jonida Shehu, e cila pavarësisht se u largua nga emisioni i pasdites, kësaj radhe ka vendosur të kthehet me një projekt të jashtëm në bashkëpunim me Petri Bozon. Ndërkaq moderatori i emisionit sportiv, Edi Manushi së bashku me bukurshen Fjoralba Ponari, do të drejtojnë së bashku emisionin e Alban Dudushit, "E Diell". Ndërkohë që ky i fundit do të largohet nga "Top-Magazine" për të drejtuar një emision me ngjyra politike. Ndërkohë që siç edhe është marrë vesh më parë lajmi për largimin e Anjeza Majës nga drejtimi i programit "Në shtëpinë tonë", pas tre sezonesh, bëri dje xhiron e të gjithë portaleve. Por programi i mesditës në "Top Channel" e ka zgjedhur tashmë moderatoren, që do të drejtojë në krah të Florian Agalliut në këtë sezon të katërt. Është Stela Kotri, prezantuesja e një serie programesh të përditshme në disa ekrane si "Vizion Plus", "Ora News", "Alsat", etj, e cila rikthehet në "Top Channel" pas shumë vitesh. Kujtojmë që ajo ka qenë drejtuese e "Top Select" përpara shumë kohësh. Sezoni i ri "Në shtëpinë tonë" pritet të sjellë ndryshime edhe



në përmbajtje, ndaj do duhet të presim se çfarë do të rezervojë ekipi i këtij programi për të gjithë ndjekësit e tyre në shtator. Për të shuar zërat dhe keqkuptimet, Maja është shprehur qartësisht se ka vendosur me vullnetin e saj të plotë të ndërpresë kontratën tre vjeçare me emisionin e paradites "Në shtëpinë tonë" për të ndjekur rrugë të tjera. Ajo konfirmon se në shtator do të nisë një aventurë të re në TV Klan, jo më si prezantuese, por si personazh në një spektakël. Para pak ditësh është zbuluar se Anjeza do të jetë një nga konkurrentet e "Dancing with the stars" ndërkohë që do të ketë edhe plot kohë që t'i përkushtohet biznesit të saj pri-



vat. Ndërkaq shumë zëra të tjerë thanë se zëri i dashur i mëngjesit në Top Chanel, Eno Popi do të largohet nga emisioni i mëngjesit. Mesa duket zërat ishin të vërtetë, por nga ana tjetër ne jemi mësuar ta shikojmë çdo sezon në ekran edhe në emisionin "100 milionë". Edhe këtë sezon Enon do të kenë mundësi ta shikoni duke drejtuar një emision të tipit game-show. Ashtu si të "100 milionë" edhe në emisionin e ri konkurrentët do të luajnë për të fituar para. Çdo konkurrent do të vendoset përballë 20 kutive që brenda mbajnë miliona lekë. Faqja e Top Channel ka bërë të ditur se emisioni do të quhet "Dilema" dhe do të fillojë së shpejti. Ky emision është si formati i emisionit të drejtuar kohë më parë nga Enkel Demi, të quajtur "Kutia e fundit", formati ky i cili është i njohur edhe në ekranet e mediave të huaja. Të presim shtatorin për të tjera ndryshime!



E 'kapën mat' me të 'fejuarin', reagon ish-banorja e 'Big Brother': Jam prej kohësh single

Pjesë e "Big Brother VIP"? Xhensila Pere: Do të konkurroja çift me një femër

"Së shpejti vij me një projekt të madh dhe një risi në ekranin shqiptar"

Pamela Aliaj

Vetëm para pak ditësh ajo u shfaq në një nga klipet e këngëtarëve më të njohur shqiptarë në superperformë. Ndërkohë që media rozë nuk është lodhur së marri me të duke e vendosur gjithnjë në qendër të vëmendjes. Kësaj radhe, ish-banorja e 'Big Brother', Xhensila Pere, thuhet se është fejuar, dhe për më tepër janë postuar edhe foto të saj me partnerin. Në një intervistë ekskluzive për 'Bluetooth' të 'Gazeta Shqiptare', Xhensila ka rrëfyer të vërtetën e fotove. E pyetur edhe lidhur me projektet e reja, ajo është shprehur se do të shfaqet në një nga projektet më gjigande të medias në fund të vitit. Ndërkaq ajo që tërhoqi vëmendje ishte dëshira për të marrë pjesë në "Big Brother Vip", por, nëse do të ishte çift, do të parapëlqente të ishte me një femër! Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Projekti më i fundit i juaj është pjesëmarrja në klipin e këngës së re të këngëtarit Gena. Si lindi ideja e të qenit pjesë e këngës?

Ky propozim më ka ardhur nga vetë Gena dhe bashkëshortja e tij, Lorena. Mënyra se si ata punojnë, plotësonin kriteret e mija, dhe duke qenë se Gena është një nga ata artistë që vlerësoj dhe ndjek, pranova të jem pjesë e projektit të tij.

Si i keni marrëdhëniet me këngëtarët shqiptarë? Cili është i preferuari juaj?

Në përgjithësi kam marrëdhënie të mira sidomos me ata të cilët kanë qenë pjesëmarrës në eventet që kemi organizuar me "Miss Universe Albania", ku jam pjesë e stafit organizativ.



Është pak e vështirë të zgjedhësh, sepse për fatin tonë të mirë kemi shumë artistë të mirë. Por do veçoja ata që bëjnë muzikë të vërtetë live, dhe këtu bëjnë pjesë Gena dhe diva e skenës shqiptare Aurela Gaçe.

A do të keni shfaqje në videoklipe të tjera?

Kurrë mos thuaj kurrë! Nëse vjen një projekt i bukur si ai i Genës, patjetër që po.

A keni patur ndonjë propozim nga ndonjë këngëtar/e që e keni refuzuar? Nëse po, pse?

Po, kam pasur dhe propo-

zime, të cilat i kam refuzuar. Dhe kjo ka ndodhur, sepse nuk ka qenë i përshtatshëm për mua. Nuk e kam gjetur veten dhe nuk kanë plotësuar disa kriteret që unë kam.

Si ishte eksperiencia e "Miss Universe Albania" 2018? Çfarë do të veçonit më tepër?

"Miss Universe Albania" tashmë është pjesë e imja. Është angazhimi im kryesor dhe aty ku unë ndjehem në shtëpinë time. Është viti i katërt që unë isha pjesë. Çdo sekondë aty është një emocion më vete dhe nuk





së tepërmi dhe do doja vërtet të merrja pjesë në ndonjë projekt kinematografik. Por aqma nuk kam marrë një ftesë të tillë. Nëse do e merrja, do pranoja pa hezitim.

Para pak kohësh doli në media se ju ishit fejuar me dikë. A është e vërtetë?

Unë kam shumë kohë që jam single dhe gjithçka ka qenë një aludim i mediave dhe portaleve.

Së fundmi ishit duke punuar me një fotoshooting të cilin e keni publikuar edhe në rrjete sociale. Për çfarë bëhet fjalë më konkretisht?

Prej dy vitesh kam një bashkëpunim me një stilist të huaj, Zlatko Jovanovski, i cili kujdeset për daljet e mia televizive. Dhe ky shooting ishte për krijimet e tij, posaçërisht për "Miss Universe Albania 2018".

Nëse ju propozojnë të merrni pjesë në "Big Brother Vip" do të pranoni?

Për mua eksperiencia e BB ka qenë një nga ato më të veçantat dhe që nuk përsëritet. Nuk e di nëse do ishte i njëjti impakt, por do ta pranoja.

Po nëse do të jetë me çifte kushti për të jetuar aty, me cilin personazh të njohur (VIP) do të pranoni për partner?

Nëse do jetë me çifte, kjo zgjidhet nga produktioni se me kë do jesh ose do ketë një mënyrë tjetër përzgjedhjeje. Nëse do ishte në dorën time, do zgjidhja një person me karakter të fortë dhe shpirt luftarak sepse pjesën tjetër "të butë" do e kompensoja unë. Nëse do kishte emra specifik, do e jepja përgjigjen më konkretisht. Por këtë radhë do preferoja të isha bashkë me një personazh femër.



mund të veçoj asnjë. Rrugëtimi deri në finalen e madhe është i gjatë, i vështirë dhe i bukur. Dhe nata finale është qershia mbi tortë pasi ato vajza të thjeshta dhe pa eksperiencë, i ke shndërruar në yje dhe shkëlqejnë si modele të vërteta.

Cili është projekti i radhës për Xhensilën? A keni ndonjë propozim lidhur me ndonjë projekt në media?

Jam në punë e sipër për një projekt timin, i cili do prezantohet në fundvit. Bëhet fjalë për një projekt të madh dhe një risi në ekranin shqiptar.

Ju keni thënë që pëlqeni edhe kinematografinë. A jeni duke punuar me ndonjë projekt të ndonjë filmi?

Më pëlqen



VIP-a në plazh

Rita Ora "nxjerr" gjoksin, rikthehet më seksi se kurrë Zaimina Vasjari, Dua Lipa shpenzon shifra marramendëse vetëm për pushime

Verës po i vjen fundi, por pushimet janë ende për t'u shijuar. Këtë gjë janë duke bërë edhe VIP-at tanë. Kësaj radhe në kolazhin e sjellë do t'ju prezantojmë pushime të çmendura, luksoze, romantike, por edhe tepër 'hot' të njerëzve të famshëm të medias rozë. Dikush ka zgjedhur të udhëtojë nëpër vendet ekzotike, dikush të harxhojë shifra marramendëse e dikush tjetër të mësojë notin për herë të parë. Ndiqni më poshtë aventurat e VIP-ave për këtë verë.

Nga Pamela Aliaj

Fotot provokuese të femrave seksi buzë detit



Pushimet e 'çmendura' të Anxhela Martinit në Kapri

Pas pushimeve në Mikonos, në Potisano e në disa vende të tjera të Mesdheut, radhën tani e ka Kapri. Modelja me origjinë shqiptare, Anxhela Martini është duke shijuar pa fund pushimet në Kapri të Italisë me bashkëshortin e saj. Ajo ka publikuar foto dhe video të ndryshme në rrjete sociale, ku shfaqet më në formë se kurrë së bashku me bashkëshortin duke shijuar bukuritë e vendit, por edhe dashurinë e saj. Të shohim ku do të jetë destinacioni i radhës i çiftit.



Rita në det, i vë "flakën" rrjetit me detajin e bikinit

Mes angazhimeve të shumta që ka duke udhëtuar nëpër botë, këngëtarja Rita Ora po vazhdon që në mes turneve të saj muzikore, të gjejë pak kohë edhe për relaks. Pak më parë ka publikuar një fotografi ku shfaqet e tëra e lagur në bikini të bardha. Por ajo që ka bërë më tepër përshtypje në këtë foto është gjoksi i saj bombastik që i doli jashtë bikinive, por ndoshta edhe vetë deshi që kjo pjesë e trupit të saj të duket ende më joshëse.



Albani dhe Miriami shijojnë pushimet në Itali

Ata janë nga çiftet më të njohur të 'showbiz-it' dhe aktualisht janë duke shijuar pushimet. Pas dasmës së trashëgimtares së "Top Channel", Sara Hoxha dhe moderatorit Ledion Liço, Alban Skënderaj dhe Miriam Cani po kalojnë disa ditë relaksi në Itali. Në foton e publikuar nga Albani, çifti dukej më i dashuruar dhe më në formë se kurrë.



Rikthehet në superformë, Zaimina shfaqet siç nuk e kishim parë asnjëherë

Këngëtarja e njohur Zaimina Vasjari ka vetëm pak kohë që ka sjellë në jetë vogëlushen e saj Khloe. Por duket se shumë pak kohë i është dashur këngëtares për të rikthyer format e saj shpërthyes. Ajo ka publikuar në rrjetet sociale disa foto sensuale ku shfaqet me bikini dhe më seksi se kurrë. Këngëtarja duket mjaft në formë se tepër sensuale. Të jetë gjenetike apo dietë e vazhdueshme?



Pas koncertit, vijnë pushimet. Ja shifra marramendëse që shpenzon Dua Lipa

Pas koncertit në Prishtinë, këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare ka udhëtuar drejt Turqisë në kuadër të turneut të saj nëpër botë. Përveç kësaj, Dua ka gjetur edhe disa momente për t'u relaksuar. Mediat turke kanë shkruar për qëndrimin e këngëtares shqiptare dhe se sa para ka shpenzuar ajo. Ato shkruajnë se Dua ka qëndruar në një vilë superluksoze dhe sipas tyre, qëndrimin i saj vetëm për një natë aty i ka kushtuar 15 mijë euro, ndërkohë shtojnë se ka pasur në dispozicion për 24 orë një helikopter privat gjatë tri ditëve dhe se për një orë shfrytëzimi ka paguar rreth 400 euro. Dua Lipa natën e kaluar performoi para publikut turk, ndërsa thuhet se krijoi një atmosferë madhështore.

VIP-a në plazh


Emina Cunmulaj një mami e dedikuar, i mëson për herë të parë notin së bijës

Përveçse supermodele dhe tepër e njohur, bukurshja me origjinë shqiptare, Emina Cunmulaj është një nga nënat më të devotshme për fëmijët e saj. Prej kohësh tashmë ajo ka nisur pushimet bashkë me familjen. Kësaj radhe pushimet janë edhe më të veçanta, pasi për herë të parë pranë tyre është edhe më e vogla e familjes, e cila erdhi në jetë disa javë më parë. Lidhja e Eminës me vajzat është shumë e fortë dhe vëmendja u kushtohet vetëm atyre. Me Ellën, më të rriturën, ajo kombinon edhe veshjet, por jo vetëm kaq. Në videot e shpeshta që ajo poston, duket se si e mëson vajzën të dojë e të kujdeset për motrën e vogël. Ndërkohë që jo më larg se dje, ajo i mësoi Ellës notin dhe kjo s'është një gjë e vogël për një nënë të devotshme si Emina.



Einxhel Shkira "shkrin" Turqinë, poston foto të trupit bombastik

Pas pushimeve që shijoi me shoqërinë në Mikonos të Greqisë, mesa duket ende nuk kanë përfunduar ditët e relaksit për bukurshen Einxhel Shkira. Kësaj radhe, destinacioni i saj i preferuar ka qenë Turqia. Ajo ka zgjedhur një nga hotelet për të shijuar këto ditë të nxehta të fundit të verës dhe ajo ka tërhequr më tepër vëmendjen me postimet e herëpashershme të bukurshes ku vihej re trupi i saj superseksi. Falë ushtrimeve të bëra para se të niste pushimet (edhe pse nuk i kishte shumë të nevojshme), Einxhel duket se ka arritur në forma për t'u pasur zili. Një bombë e vërtetë!



Olta Gixhari shijon pushimet në varkë, tërheq vëmendjen komenti i Jul Dedës

Vijojnë pushimet edhe pse jemi në fund të verës edhe për aktoren e njohur, Olta Gixhari. E shtrirë në varkë me një gotë verë të bardhë në dorë, Gixhari duket se po i shijon në maksimum këto ditë vere. Edhe pse nuk kanë vonuar as komentet ngacmuese të ndjekësve të saj, ku ndër ta bie në sy ai i Julian Dedës që shkruan: "Qyqja mi goc se do ftohesh... se fryn aty". Dhe natyrisht s'kishte se si të ndodhte ndryshe me një humorist të tillë që 'i thumbon' kur ka kohë edhe VIP-at.



Largohet nga "Portokalli", "Kimikati" prek me mesazhin: Po iki i përlotur...

Jo më larg se disa ditë më parë, në media ka qarkulluar lajmi për largimin e aktorit të njohur të humorit Olsi Bylyku ose siç njihet ndryshe "Kimikati" nga "Portokalli". Ndërkohë që ditën e djeshme, aktori ka ndarë me ndjekësit e tij në rrjetet sociale një status falënderues dhe mjaft prekës për të gjithë stafin dhe kolegët me të cilët ka punuar gjatë gjithë kësaj kohe. "E ndjej detyrim të sqarohem për të gjithë ju që më keni shkruar, më keni telefonuar dhe pyetur pa fund mbi largimin tim nga 'Portokalli', por mbi të gjitha për të gjithë publikun që më ka ndjekur dhe mbështetur në rrugëtimin tim deri më sot. Po, është e vërtetë që nuk do të jem më pjesë e emisionit që më hapi dyert e ëndrës sime, për ta vazhduar në 1 tjetër angazhim artistik. I jam mirënjohës gjithë jetën regjisorit Altin Basha, që më dha mundësinë të shpreh talentin tim! Falënderit të gjithë aktorëve ose me saktë idhujve të mi, në batutat e të cilëve u rrita dhe pata fatin të jem kolegj me ta! Falënderit 'Top Channel' për hapësirat që më ofroi në televizion! Falënderime pafund për publikun tim, frymëzimin dhe energjinë e pashtershme që buron në çdo duartrokime. Po iki i përlotur për punën që investova dhe marrëdhëniet njerëzore që arrita të krijoj, për të qeshur me të ardhmen që do projekttoj pranë publikut shqiptar dhe marrëdhëniet e reja që do ndërtoj... Zoti ju ruft!", - ka shkruar "Kimikati".



Një tjetër dasmë, ja çifti i 'showbiz'-it që do të lidhë kurorë këtë fund vere

Mund të themi se gushti quhet ndryshe edhe si muaji i dasmave. Reperi i njohur Gjiko dhe e fejuara e tij Elita Rudi duket se do të kurorëzojnë dashurinë e tyre në martesë pas disa ditësh. "Prive.ai" ka zbuluar se çifti do të martohet pikërisht në datën 23 gusht. Në muajin qershor Gjiko i propozoi fejesë të dashurës së tij, ndërkohë pak javë më parë në media u përfol për një shtazëni të mundshme tëELITës. Dasma e përsheptuar mbase konfirmim zërat që qarkulluan për shtazëninë e saj.

Më në fund e bëri publike, Adelina Tahiri publikon fotografinë e bashkëshortit

Vetëm pak ditë e ndajnë këngëtarën shqiptare Adelina Tahiri për të sjellë në jetë fëmijën e saj të parë. Pas martesës së saj me biznesmenin Serjoza Markov, këngëtarja ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes mediatike. Vetë Adelina është treguar shumë e rezervuar, sepse nuk ka preferuar të shfaqet në një fotografi të plotë me bashkëshortin e saj. Gjithmonë në rrjetet sociale ajo ka zbuluar fotografi nga momente të veçanta me të, duke u kujdesur të fsheh fytyrën. Megjithatë, duket se tani që të dy presin të bëhen prindër të një djali, Adelina po tregohet më e hapur me publikun. Ditën e sotme ajo ka publikuar një fotografi të bashkëshortit të saj në makinë, edhe pse edhe këtë herë është kujdesur që Serjoza të mos shfaqet plotësisht duke e fotografuar në profil. Pavarësisht se këngëtarja ka thënë gjithmonë se ndihet shumë e lumtur pranë tij, edhe kësaj radhe nuk kanë munguar komentet negative nga fansat për diferencën e madhe në moshë mes të dyve.



Shpat Kasapi preket aty ku s'mban më, ngrihet dhe ikën nga emisioni!

Jo të gjitha shakatë janë të pranueshme dhe këtë e ka bërë të qartë edhe këngëtarja e njohur, Shpat Kasapi. Një shaka realizuar në studion e "Kojshia Show" është konsideruar totalisht pa kripë për të, aq sa e shtyu të largohej nga emisioni pa e menduar dy herë. E gjitha nisi kështu: Shpati po bisedonte mirë e bukur me moderatorin kur krejt papritur hyn një vajzë dhe ulet pranë këngëtarit. Vajza prezantohet dhe thotë se është e dashura e Shpatit. Mendohet pak dhe shprehet: "Edhe këtë ma bërë? Ika..." ngrihet nga kolltuku dhe shkon drejt daljes. "Pse ku po shkon?" reagon me të shpejtë moderatori dhe sado që përpiqet ta tërheqë dhe ulë sërish është e kotë. Shpati u prek dhe u prek keq ama!



Tuna poston foton e ëmbël të vogëlushit Tian

Pas ardhjes në jetë e fëmijës të parë, kjo bëri që këngëtarja e njohur Tuna të shkëputej për një kohë të konsiderueshme nga tregu muzikor. Këngëtarja preferoi t'i përkushtohej rritjes së të voglit, derisa pak ditë më parë u rikthye sërish në bazë! Por teksa poston video të fansave duke kënduar këngën e saj më të re 'Chonga', Tuna nuk kursen për ne një foto shumë të këndshme të Tianit: "Ama unë ty të dua më shumë se veten", shkruan mami Tuna ku ka shqiptarë.



Opinion *i* Ditës

Ndarja Kosovë–Serbi mund të shkaktojë konflikte

Nga Vesko Garçević

... e kufijve në Ballkan dhe hodhi poshtë çdo shkëmbim të mundshëm të territoreve. Një mesazh i vendosur i këtij lloji është në kohë dhe i rëndësishëm, por rajoni ka nevojë për më shumë se fjalë. Ai ka nevojë për mbështetje të prekshe politike dhe një perspektivë të ringjallur të BE-së. Anëtarët kryesorë të BE-së, me Gjermaninë që kanë përgjegjësi të veçantë, duhet të rrisin angazhimin e tyre në rajon dhe të veprojnë në mënyrë parandaluese.

Një shkëmbim territori midis Kosovës dhe Serbisë mund të provokojë një reagim zinxhir dhe të shkaktojë paqëndrueshmëri në të gjithë Ballkanin, ndërsa Perëndimi duhet të zgjojë pasojat, potencialisht shkatërruese. Vitin e kaluar republikani i SHBA-ve, i cili është akuzuar se është "Kongresmeni i preferuar i Putinit", Dana Rohrabacher, i dërgoi një letër Presidentit të Serbisë, duke i kërkuar udhëheqjes serbe ta konsiderojë shkëmbimin e territoreve me Kosovën. Në atë moment, kjo duket si një shaka e keqe, e bërë nga dikush që nuk e kuptonte historinë dhe kompleksitetin e Ballkanit. Megjithatë propozimi i Rohrabacher u dënua nga politikanët në të gjithë rajonin, ky kongresmen i diskutueshëm bëri publike atë që shumë në Beograd (dhe ndoshta në Prishtinë) kanë në mendje. Sot, propozimi i Rohrabacher është afër të ndodhë. Fushata për të është gati dhe negociatat e reja mbi "ardhmërinë e Kosovës" duken pothuajse të pashmangshme.

Presidenti serb, Aleksandar Vučić dëshiron një marrëveshje historike me Kosovën. Partneri i tij në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, të ndërmjetësuar nga BE-ja, Presidenti Hashim Thaçi, nuk është aq i sinqertë, por ai kurrë nuk ka kundërshtuar plotësisht idenë e rimarrjes së kufijve. Projektligji i Asociacionit të Komunave të Serbisë, që do të përfaqësojë interesin e serbëve në Kosovë – një armë e fuqishme politike në duart e Beogradit ose "makthi i Prishtinës" siç e quajnë disa, ka gjasë të përfundojë në gusht. Shumë prej tyre janë të shqetësuar se negociatat mbi statusin e shumëpritur do të shërbejnë si një prelude për rregullimin e një shkëmbimi territorial. Nuk është çudi që Presidentit të Republikës Srpska, Milorad Dodik, i pëlqen plani, pasi ai kërkon një mundësi më të madhe për vete. Ish-bashkëpunëtorët e fushatës së presidentit Donald Trump, Jason Osborne dhe Mike Rubine janë angazhuar kohët e fundit si lobistë për Dodik. Detyra e tyre është të ndihmojnë Dodik të krijojë, nëse është e mundur, mbështetje në Uashington për planet e tij, për të ndarë "pjesën e tij"



nga Bosnja dhe Hercegovina. Mund të jetë më e realizueshme nëse plani i ri i Kosovës funksionon. Të dy ata ndihmuan të organizonin takime për Kryeministrin e Republikës Srpska, Zhejljka Cvijanović gjatë vizitës së saj në Uashington disa javë më parë, duke përfshirë takime me kongresmenin Rohrabacher dhe ish-shefin e strategjisë së Shtëpisë së Bardhë, Steve Bannon. Një shkëmbim territori midis Kosovës dhe Serbisë jo vetëm që do të mundësojë ëndrrat e vjetra të Serbisë së Madhe dhe të Shqipërisë së Madhe, por edhe do të provokojë një reaktion zinxhir në të gjithë rajonin. Republika Srpska është vetëm një nga dhjetëra pikat e problemeve rajonale. Nuk është vështirë për të kuptuar se tregtia e mundshme territoriale është një rrugë për një paqëndrueshmëri në rajon dhe mund të prodhojë pasoja katastrofike. I ngarkuar me një sërë çështjesh të pazgjidhura dypalëshe, të prishura nga gjakderdhja e viteve 1990 dhe i paqartë për t'u marrë me fantazmat e së kaluarës së saj, rajoni mund të zbrësë lehtësisht në një konfrontim të plotë. Fakti që politikanët në Ballkan më tepër do të reduktojnë kufijtë, sesa ndryshojnë politikat e tyre nuk është befasi. Ajo çka përbën një surprizë është qëndrimi i butë i zyrtarëve nga Perëndimi për këtë ide. Ndryshimi në mjedisin politik në Evropë dhe marrëdhëniet e den-dura midis Evropës dhe SHBA-ve i

kanë bërë politikanët nga Ballkani të besojnë, se tani është koha për të bërë planet e tyre realitet. Ndërmjet sfidave strukturore të tilla si, Brexit ose rregullat financiare dhe sfidat e sigurisë, siç janë situata e Ukrainës dhe Rusisë, kriza e emigrantëve, Lindja e Mesme apo rajonit i Sahelit në Afrikë, ku Franca ka sugjeruar krijimin e një force të përbashkët ushtarake evropiane, BE-ja po lufton për të ruajtur unitetin e saj. Kriza e emigrantëve është shembulli më i qartë i paaftësisë së BE-së, për të rënë dakord mbi një politikë të përbashkët, në një fushë të prekshe që përfshin çështjet e migracionit, sigurisë dhe pyetjeve relevante për identitetin kulturor dhe kombëtar. Kështu pothuajse çdo ditë, anijet e shpëtimit në Mesdhe, duhet të presin që një shtet anëtar i BE-së, të tregojë mëshirë dhe të pranohet një grup të ri emigrantësh. Për më tepër, rritja e nacionalizmit dhe popullariteti i lëvizjeve ekstreme të së djathtës në Evropë dhe SHBA kanë sjellë mbresa ideologjinë e "gjakut dhe tokës". Kjo rezonon në mënyrë të konsiderueshme me nacionalizmin e Ballkanit. Marrëdhëniet SHBA-BE janë jo të suksesshme.

Mosmarrëveshjet me administratën aktuale amerikane dhe një luftë tarifore në vazhdim me SHBA-të është gjëja e fundit që Brukseli ka nevojë në këtë moment. Kjo shoqërohet me mosangazhimin gjithnjë e më të madh të

Uashingtonit në rajonet me rëndësi gjeopolitike periferike për SHBA-të, gjë që është frymëzuese për udhëheqësit lokalë dhe ambiciet e tyre maksimale. Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor është shumë larg, nga lista e prioritetëve të BE-së. Ata janë larg syrit për Uashingtonin. Një situatë ideale për ata që dëshirojnë të rishikojnë kufijtë dhe historinë. Presidenti Vučić mund të ndehet i inkurajuar nga një BE e vakët, me mosmarrëveshjet e saj me SHBA-të dhe me deklaratat e huata diplomatike që vijnë nga Brukseli dhe Uashingtoni. Këto reagime të parrezikshme ndaj idesë së ndarjes konfirmojnë se Perëndimi ka çështje të tjera më të rëndësishme për t'u marrë me të dhe nuk ka kohë të mjaftueshme për rajonin. Së pari, ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Greg Delawie, hezitoi të japë një përgjigje të drejtë, nëse SHBA-të përjashtojnë ndarjen si një rezultat të bisedimeve të Serbisë dhe Kosovës. Duke pasur parasysh se rajoni është shumë larg për agjendën e Departamentit të Shtetit, ai mund të ketë pasur një problem, me mungesën e udhëzimeve nga qendra e tij. Pjesa më shqetësuese është paqartësia që vjen nga zyra e Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini. Në një deklaratë të fundit publike, zyra e saj bëri të qartë se "Serbia dhe Kosova po përcaktojnë bazën e tyre për pajtim të përbash-

kët". Kur ambasadori i SHBA-ve, në Beograd, Kyle Scott, kërkoj "një marrëveshje gjithëpërfshirëse", Vučić mund të imagjinojë një zgjidhje "të favorshme", pasi presidenti serb përshkroi ndarjen e mundshme të Kosovës. Ambiguiteti diplomatik konstruktiv nuk funksionon mirë në rajonin tonë. Në të njëjtën kohë, ambasadori rus në Beograd, Aleksander Chepurin, nuk ka problem me dykuptimësinë, duke thënë se nëse "kjo është ajo që Serbia dëshiron, Rusia mbështet ndarjen e Kosovës". Kjo është arsyeja pse disa shoqata qytetare dhe OJQ nga Serbia dhe Kosova, i bënë thirrje BE-së që të reagojë kundër ndonjë ideje për ndarjen e Kosovës. Ata që nuk mësojnë nga historia janë të destinuar ta përsërisin atë. Një sinjal i mirë erdhi nga kancelaria gjermane Angela Merkel, e cila konfirmoi paprekshmërinë e kufijve në Ballkan dhe hodhi poshtë çdo shkëmbim të mundshëm të territoreve. Një mesazh i vendosur i këtij lloji është në kohë dhe i rëndësishëm, por rajoni ka nevojë më shumë se fjalë. Ajo ka nevojë për mbështetje të prekshe politike dhe një perspektivë të ringjallur të BE-së. Anëtarët kryesorë të BE-së, me Gjermaninë që kanë përgjegjësi të veçantë, duhet të rrisin angazhimin e tyre në rajon dhe të veprojnë në mënyrë parandaluese.

Balkan Insight

Dje në "Deutsche Welle"

E ardhmja e dollarit

... ta gremisë atë vetë.

A ËSHTË VËRTETË KËSHTU?

Nëse stabiliteti i monedhave është i kushtëzuar nga besimi kundrejt emitenteve të tyre, atëherë perspektiva e dollarit nuk është e mirë. Nga Uashingtoni Donald Trump lufton kundër pjesës tjetër të botës. Në kulmin e luftës tregtare me Kinën presidenti amerikan atakon Rusinë dhe Turqinë - por ato kundërsulmojnë dhe e godasin Uashingtonin aty ku i dhemb më shumë: Ato e venë në pikëpyetje pozicionin drejtues të fuqisë botërore, fillimisht vetëm lidhur me monedhën.

KU NISI E GJITHA

Fillimin e kursit të fitores monedha amerikane e pati më 14 shkurt 1945 në kryqëzimin USS Quincy, që sapo ankorohet në liqenet egjiptiane përreth kanalit të Suezit. Në anijen e mbrojtur me armë zjarri ishte areduar një dhomë pritjeje: disa kolltukë të mbledhur të importuar dhe tavolina të vendosura mbi një tapet oriental. Në sfond ishin paretet e forta të anijes së fuqishme të flotës ushtarake të SHBA-së. Vetëm pak persona ishin të pranishëm. Presidenti amerikan Roosevelt i premtoi mysafirët saudit mbrojtje ushtarake dhe mbreti Ibn Saud mori përsipër që për këtë në të ardhmen t'i kryejë në dollarë bizneset e naftës.

Gati dhjetë vjet më vonë, pas shfuqizimit të standardit të arit, "Greenback" (dollari) sërish u kushtëzua nga një lëndë e parë, e kjo ishte ari i zi, pra nafta.

Një rast fatlum ky për SHBA-në, sepse kërkesa për naftë në vitet që pasuan u rrit shpejt dhe me këtë si rrjedhojë edhe kërkesa për monedhën amerikane. Shpejt gjithnjë e më shumë biznese në nivel ndërkombëtar nisën të kryhen me dollarë.

E kjo vazhdon edhe sot e kësaj dite kështu. FMN-ja vlerëson, se rreth 62 përqind e rezervave të monedhave në botë mbahen në dollar. Për krahasim: Euro përbën 20 përqind të rezervave monetare, pas kësaj vjen yen dhe paundi.

Edhe transaktonet e valutës bëhen pothuajse të gjitha me dollarë, mbi 85 përqind e këmbimeve ndërkombëtare të valutës llogariten me dollarin.

Banka amerikane e Rezervave, FED, e ka mbështetur vazhdimisht funksionin orientues të dollarit dhe është kujdesur për të pasur likuiditet të mjaftueshëm. Edhe prej kësaj dominancë e monedhës amerikane prej kohësh është një gjendje, që ajo e ruan vet.

ÇËSHTJA E ANKORIMIT TË SIGURTË

Likuiditeti i dollarit e bën atë për depozituesit interesant si një port i sigurtë ancorimi - sepse ai mund të tregtohet shpejt. Por kjo mund të shkaktojë edhe situata groteske: nëse në një kategori tjetër depozitimi situata është rrishte, investitorët - ndër ta natyrisht edhe bankat qendrore e sipërmarrjet - largohen madje edhe prej Dollarit, në rast se pikërisht në Amerikë kërcënojnë rrizqet më të



mëdha për ekonominë botërore. Kjo ndodhi së fundi gjatë krizës financiare, ose edhe në valën e grindjes së vazhdueshme në Kongresin e SHBA-së për kufirin maksimal të borxhit.

Ekonomisti Barry Eichengreen e quan këtë një "privilegj të paturpshëm" për SHBA-në. Sepse dy rivalët më të rëndësishme kanë probleme: Euro, sipas Eichengreen, është një monedhë pa shtet, dhe Renminbi kinez një monedhë me shumë shtet. Kjo do të thotë, që me dobësimin e euros nuk ka një qeveri, e cila të mund të marrë përsipër stabilitetin e monedhës. Monedha kineze në të kundërt kontrollohet prej udhëheqjes politike dhe jo nga forcat e ekonomisë së tregut.

MË PAK DOMINANCË E DOLLARIT?

Në SHBA ndërkohë është e vështirë, që duke iu referuar politikës dhe ekonomisë të flasësh për një situatë të kontrolluar. Presidenti Trump nuk steptet, të akuzojë vendet e tjera - jo vetëm Kinën si konkurrenca të monedhës - për manipulime me Renminbi, për të shkruar me pas në një Tweet rekomandimet për Bankën Kombëtare të Rezervave lidhur me politikën monetare. Ndonëse Banka amerikane e Rezervave deri tani po ndjek një kurs të qëndrueshëm dhe të paprekshëm, qëkurse shtëpia e bardhë ka nisur të japë hapur rekomandime dhe kërkesa si p.sh. lidhur me interesin orientues, është e paqartë, nëse mund të kesh

gjithmonë besim tek neutraliteti politik i FED.

As për kursin e politikës ekonomike të Trumpit askush nuk guxon të japë garanci. Veprimet e tij shumë shpesh janë kontraktore: Ai flet për marrëveshje të mëdha tregtie, por ato deri më tani nuk janë zbatuar veçse ka pasur anulime e ai nuk i është përmbajtur asnjëherë prej tyre. Një grindje tregtare me Kinën, pasiguria në raportet me Rusinë, e së fundi grindja me Turqinë, që po e zhyt lirën në humnerë pa fund...Duket sikur Dollari në gjendjen aktuale nuk është një bankë e sigurtë.

Shtrohet pra pyetja: cila monedhë do të dirigjojë në të ardhmen? Rusia dhe Turqia kanë deklaruar, se në tretërinë ndërkombëtare duan të kthehen tek monedhat e tyre - ato duan t'ia kursëjnë vetes rrugën e tërthortë përmes Dollarit. Ndoshta edhe vende të tjera do të ndjekin këtë shembull dhe Dollari në tretërinë globale do të jetë më pak dominant. Por ai do të mbetet monedha më e fortë në vetvete, për aq kohë sa SHBA edhe në kaosin më të madh gëzon besimin më të madh se shtetet e tjera pas monedhave të tjera.

As për kursin e politikës ekonomike të Trumpit askush nuk guxon të japë garanci. Veprimet e tij shumë shpesh janë kontraktore: Ai flet për marrëveshje të mëdha tregtie, por ato deri më tani nuk janë zbatuar veçse ka pasur anulime e ai nuk i është përmbajtur asnjëherë prej tyre.

HOROSKOPI

DASHI
Shmangni stresin e tepërt, pasi do t'ju shtojë lodhjen gjatë ditës. Përpunoni të kontrolloni shpenzimet dhe blini vetëm artikuj të rëndësishëm. Të gjithë kanë dëshirë të të kenë mik dhe kjo do t'ju lumturtojë pamasë. Edhe marrëdhënia në çift do të shkojë mjaft mirë sot, madje nuk do të ketë asnjë ankese nga partneri/partnerja juaj.

DEMI
Veprimet tuaja të shpejta do t'ju ndihmojnë të zgjidhni problemet afatgjata. Lidhja juaj romantike do të pësojë një kthesë shumë të bukur sot. Edhe në punë do të merrni vlerësim të shkurtra. Ka gjasa që të bëni një udhëtim brejtë të papritur.

BINJAKET
Shpenzoni kohën tuaj të çmuar me fëmijet, në mënyrë që të çlirohni nga stresi. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet për shkak të disa fitimeve të papritura. Ka gjasa që sot të acaroheni shumë në punë, por përpunoni të shmangni konfliktet e mundshme.

GAFORJA
Mos e lodhni veten me shumë seç mundeni dhe përpunoni të relaksoheni. Qëndroni sa më pranë të afërmeve, pasi do t'ju vlejë shumë. Nëse sot do të tentoni t'i shmangeni një situatë të sikletshme, ajo do t'ju ndjekë gjatë gjithë kohë.

LUANI
Një ditë e bukur ju pret, plot energji. Do t'ju vijë në mendje ide brilante, të cilat do t'ju sjellin të ardhura shumë të mira financiare. Sa i përket anës romantike, është dita juaj me fat. Nëse keni ndërmend të organizoni një festë, shumë persona do të kishin dëshirë të ishin të ftuar.

VRIGJERESHA
Kërkoni ndihmën e një mikut/mikes suaj për të zgjidhur një problem me të cilin ka gjasa të përballeni gjatë ditës së sotme. Mund të përjetoni tension në familjen tuaj. Sot mund të zbuloni arsyen pse shefi juaj sillat aq ashpër me ju.

PESHORJA
Bëni kujdes me shëndetin dhe përpunoni të mendoni vetëm pozitivisht, pasi kjo do t'ju ndihmojë shumë. Mund të merrni një dhuratë nga dikush që e doni fort. Sa i përket punës, ka gjasa që të ngriheni në detyrë. Sot mund vini re një veprim të çuditshëm të partnerit/partneres suaj.

AKREPI
Sot mund të përballeni me disa opinione të ndryshme rreth një çështje, çfarë do t'ju iritojë shumë. Shmangni personat që iu afrohen vetëm për interes, sidomos ata që kërkojnë borxhe. Sa i përket anës romantike, sot do të përjetoni diçka fantastike.


SHIGJETARI
Sado që të përpigjeni, nuk do të mund të plotësoni kërkesën e dikujt. Bëni mirë të përqendrohni dhe të mos humbni kontrollin. Shmangni shpenzimet e tepërta dhe skemat e dyshimita financiare. Mbrëmja me miqtë do t'ju kënaqë pamasë.

BRICJAPI
Azhenda juaj ju shumë e ngarkuar do t'ju mundësojë kohën e duhur për t'u relaksuar. Megjithatë bëni mirë të përfshiheni në disa rregullime në shtëpi. Një takim i papritur romantik do t'ua ndryshojë tërësisht ditën.

UJORI
Sot do të ndihen shumë të lodhur, pasi nuk keni pushuar aq sa duhet gjatë javës. Kontrolloni tendencën për të shijuar momentin dhe për të shpenzuar shumë para për argëtim. Shijoni një ditë të qetë me familjarët tuaj.

PESHQIT
Kuptoni potencialin tuaj të vërtetë, sepse nuk iu mungon forca por vullnet. Ka gjasa të merrni një lajm të papritur nga një i afërm juaj. Nëse keni vendosur të udhëtoni, kontrolloni momentin e fundit dokumentet e rëndësishme, pasi ka gjasa t'i hamoni. Çiftet e martuara do të kalojnë një ditë të shkëlqyer.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursemi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I ashtë.
15. Eshtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuarët.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.

39. Eshtë përfaqesja e Adriam Uthu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshtë e re pas Krishtit.
43. Shkruset për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nyja që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshtë metri i trobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministrinë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.


35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kujfj.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lujjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicialat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



- iluzion dhe çdo gjemb është një realitet.
- Nëse mbyllni derën për të gjitha gabimet, e vërteta do të qëndrojë jashtë.
- Gruaja është si trëndafil: petalet bien për një javë, por gjembat mbeten.
- C'ke në xhep ta marrin menjëherë, c'ke në tru sta marrin dot kurrë.
- Disa njerëz shfryjnë sepse trëndafilat kanë gjemba. Unë jam mirënjohës që gjembat kanë trëndafila.

Thënie të mençura

- E drejta nuk mund të jetë kurrë e të dy palëve, ajo i përket vetëm njërit.
- Gabimi më i madh që mund të bëni në jetën tuaj është të kesh frikë vazhdimisht se do bëni gabim.
- Kënaqësia i bën të varfërit të pasur, pakënaqësia i bën të pasurit të varfër.
- Eshtë akt kriminal vjedhja e një çante, e guximshme vjedhja e një pasurie, dhe madhësi vjedhja e një mbretërie. Akuza zvoqëlohet kur faji rritet.

SUDOKU

5			4	6				7
	4			3				
6			2	5				
	2		1	9	4			5
9	5						8	1
		9	2			4		
3				7				2
			6			7	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	2	1	9	8	6	3	7	4
3	6	9	7	1	4	5	8	2
8	7	4	3	5	2	9	1	6
6	9	7	5	2	8	1	4	3
4	3	5	1	9	7	2	6	8
2	1	8	4	6	3	7	5	9
9	4	6	2	7	5	8	3	1
7	8	2	6	3	1	4	9	5
1	5	3	8	4	9	6	2	7

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		M	I	K	E		K	M		S		E				
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	E	K	A			R	O	M	A	K	E	T			
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	K		M	I	L	I	T	A	N	T	E	T			
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5																
12	5	13	5	10	1	7		6			13	P	A	S	A	N	I	K		T		S				
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	E	K	U		A	N	E	T	A	R	E	T			
8	2	6	2			1	8	5	11	1		R	E	T	E		E	I	R	A	N	I				
1	6	8	17	9	5	7	2			9		I	T	R	B	L	A	K	E		L					
3	1	5		8	2	16			2	7	1	M	I	A		R	E	D		E	K	I				
2				3	2	6	5	9	2		1	E			M	E	T	A	L	E		I	S			
6	2	7	2			3		7	10	3	6	T	E	K	E		M		K	U	M	T				
3	4	8	5	19	1	5				3	5	2					M	O	R	A	V	I	A	M	A	E

